


PASIVIZIMI I ADRESAVE TË SHQIPTARËVE

në Luginën e
Preshevës si praktikë
diskriminuese



Impressum

Botues

Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YIHR Serbi)
Dobraçinit 4, Beograd

Për botuesin

Bojan Stanković

Autorët

Marko Millosavljević
Dr Millosh Rashiq

Prevod

Fehmi Maliqi

Dizajni dhe faqosja

Boris Firicki

Raporti “Pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës si praktikë diskriminuuese” është pjesë e projektit “Shpërfaqja e praktikave diskriminuuese në Luginën e Preshevës” të cilin Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut e ka realizuar bashkë me Këshillin për të Drejtat e Njeriut në Bujanoc, me mbështetje të Fondacionit Rockefeller nga Shtetet e bashkuara të Amerikës



Përmbajtja

Hyrja	3
Metodologjia	4
Struktura demografike e të anketuarëve	8
Udhërrëfyesit	9
Pasqyra historike dhe politike e Luginës së Preshevës	12
Popullësia e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës	15
Gjetjet kryesore të Raportit	18
Rastet në Gjykatën Kushtetuese	24
Katalogu i të drejtave potencialisht të shkelura	25
E drejta në vendbanim	27
Analiza e materialit nga tereni	29
Qytetarët	29
Akterët dhe aktivistët politikë	33
Citimet dhe deklaratat e përfaqësuesve shtetëror të Serbisë në kontekst të pasivizimit të adresave në Luginën e Preshevës	36
Gjetjet e organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare me rastin e abuzimit me pasivizimin e adresave	38
Problemet e tjera të diskriminimit të shqiptarëve në Serbi	41
Rekomandime për Institucionet e Republikës së Serbisë	44

HYRJE

Në periudhën nga korriku deri në shtator të vitit 2023, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka kryer hulumtime në komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës, me qëllim të shqyrtimit të praktikave diskriminuese lidhur me keqpërdorimin e Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e qytetarëve nga 2011, duke u fokusuar veçanërisht në pasivizimin e adresave të shtetasve me përkatësi kombëtare shqiptare. Mekanizmi ligjor i pasivimit të adresave është shënimi në evidencën e organit kompetent se shtetasi nuk banon në adresën e vendbanimit apo vendqëndrimit të regjistruar.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit është miratuar në vitin 2009 si shprehje e përpjekjeve për rregullimin e fushës, rregullimi ligjor i së cilës është një nga parakushtet themelore për gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Para këtij ligji, i cili parashikon ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit dhe përcakton termat bazë në këtë fushë, është miratuar Ligji për Parandalimin e Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara nga viti 2006. Ishte akti i parë në legjislacionin tonë kundër diskriminimit.

Ligji mbi Ndalimin e Diskriminimit e definon diskriminimin dhe trajtimin diskriminues si çdo dallim të pajustificuar ose trajtim të pabarabartë, përkatësisht, lëshim (përrjashtim, kufizim ose përparësi), në lidhje me personat ose grupet, si dhe anëtarët e familjeve të tyre ose personat e afërt me ta, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, e cila bazohet në racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen, shtetësinë, origjinën kombëtare ose etnike, gjuhën, bindjet fetare ose politike, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, statusin pasuror, lindjen, karakteristikat gjenetike, gjendjen shëndetësore, aftësia e kufizuar, statusi martesor dhe familjar, bindjet, moshë, pamja e jashtme, anëtarësimi në organizata politike, sindikale dhe të tjera dhe karakteristikat e tjera personale reale ose të supozuara. Karakteristikat e përmendura personale nga teksti ligjor nuk paraqesin një listë të mbyllur, kështu që mund të flitet për diskriminim në rastin e diskriminimit të pajustificuar apo trajtimit të pabarabartë bazuar në ndonjë karakteristikë apo status tjetër personal, të cilat nuk janë të përcaktuara shprehimisht në Ligj.

Ekipi hulumtues i Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut ka realizuar

katër vizita në terren, në Luginën e Preshevës, gjatë të cilave janë organizuar 23 intervista të thelluara me qytetarë, 24 intervista të thelluara me përfaqësues të akterëve politikë, përfshirë përfaqësues të komunave të Bujanocit dhe Preshevës, si dhe me përfaqësues të Trupit Koordinues të Qeverisë së Serbisë për tri komunitat në jug të Serbisë. Raporti që keni para jush është shkruar me synimin që të jetë udhërrëfyes për institucionet e Serbisë, të cilat do të hetojnë në plotëni akuzat për zbatimin restriktiv të pasivizimit të adresave për shtetasit e Serbisë të përkatësisë shqiptare.

Çështja e pozitës së pakicave kombëtare ka një rëndësi të madhe për përfundimin me sukses të negociatave për kapitullin 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore). Në këtë drejtim, pa integrimin e plotë të qytetarëve të përkatësisë shqiptare, përveç çështjeve tjera të rëndësishme, do të varet se kur dhe në çfarë mënyre Serbia do të ndërtojë institucionet demokratike dhe do të integrohet në Bashkimin Evropian.

METODOLOGJIA

Metodologjia e aplikuar në këtë punim bazohet në kërkime cilësore, veçanërisht nëpërmjet kryerjes së intervistave të thelluara, diskutimeve në fokus grupe dhe udhërrëfyesve. Zbatimi e intervistës së thelluar është një metodë kërkimore cilësore që mundëson mbledhjen e informacionit gjithëpërfshirës për një fenomen të caktuar. Kjo lloj interviste gjeneron të dhëna që janë më të detajuara dhe më të gjera në krahasim me përgjigjet e drejtpërdrejta dhe të shkurtra të marra nëpërmjet një ankete ose metodave të tjera të ngjashme.¹ Diskutimet në fokus grup janë gjithashtu një metodë kërkimore cilësore e përdorur për të mbledhur të dhëna përmes ndërveprimit në grup për një temë ose çështje specifike. Kjo metodë përfshin bashkimin e një grupi pjesëmarrësish që kanë karakteristika ose përvoja të ngjashme dhe mundëson diskutimin rreth një sërë temash të paracaktuara.²

1 Vučinić Nešković, Vesna. 2013. *Metodologija terenskog istraživanja u antropologiji: od normativnog do iskustvenog*. Beograd: Qendra Gjenealogjike Serbe dhe Departamenti i Etnologjisë dhe Antropologjisë i Fakultetit Filozofik.

2 Agar, Michael and James MacDonald. 1995. "Focus Groups and Ethnography". *Human Organizations* 54(19): 78-86.

Një tipar kyç i diskutimeve në fokus grup është përdorimi i ndërveprimit në grup si një mjet për të nxjerrë të dhëna dhe njohuri, që pa këtë mënyrë, do të ishin më pak të disponueshme.³

Gjatë hulumtimit kishim për qëllim të përdornim intervista të thelluara gjysmë të strukturuar për të ekzaminuar njerëzit që ishin të ekspozuar drejtpërdrejt procesit të pasivizimit të adresave, të atyre që mësuan për pasivizimin në mënyrë indirekte nga anëtarët e të afërmeve të tyre, komunitetit të gjerë apo miqve të tyre, si dhe politikanë dhe aktivistë lokal që u morën me këtë problem. Në këtë mënyrë, ne donim të kuptonim më mirë: (i) përvojat e tyre me rastin e pasivizimit të adresave; (ii) kufizimet me të cilat u përballën kur adresat e tyre u pasivizuan; (iii) ndërveprimi me shërbimet shtetërore në këtë proces, me referencë të veçantë për qëndrimin e policisë ndaj qytetarëve të pasivizuar; (iv) akses në informacionin që të anketuarit kanë në lidhje me pasivimin; (v) dhe proceset më të gjera të diskriminimit të lidhura me këtë problem.

Intervistat e thelluara të zbatuara gjatë hulumtimit përfshinin pjesëmarrjen e deri në dy të anketuarve në të njëjtën kohë, të udhëhequra nga një ose dy hulumtues. Intervistat u kryen në mjedise të ndryshme: në shtëpitë e të anketuarve, në organizata joqeveritare lokale, në ente publike (p.sh. qendra kulturore dhe biblioteka) dhe në restorante lokale. Metoda e përzgjedhjes së të anketuarve ishte sipas ekstraktit pa propabilitet, e që ishin të qëllimta, përkatësisht të dedikuara për ekspertizë, i cili përfshin ata individë, përvoja personale e të cilëve mund të ofrojë një këndvështrim përkatës për temën e hulumtimit.⁴ Ekstrakti i të anketuarve është kryer me ndihmën e organizatave joqeveritare lokale ose individëve të cilët gjatë hulumtimit na kanë referuar te qytetarë të tjerë me përvojë të pasivizimit të adresave të vendbanimit (e ashtuquajtura teknika snowball).

Intervistat e thelluara u përplotësuan me diskutime në fokus grupe të zhvilluara në situata ku ishte e mundur të organizohej një grup më i madh të anketuarish, të cilët ndajnë përvoja të njëjta ose të ngjashme me proceset e pasivizimit të

3 Morgan, David. 1988. *Focus Groups as Qualitative Research*. Newbury Park: Sage.

4 Vučinić Nešković, Vesna. 2013. *Metodologija terenskog istraživanja u antropologiji. Od normativnog do iskustvenog*. Beograd: Qendra Gjenealogjike Serbe, f. 34.

adresave. Diskutimet në fokus grup përfshinin mesatarisht 4 deri në 7 të anketuar, të kryera nga dy studiues.

Gjatë intervistave të thelluara dhe diskutimeve në fokus grupe, përmes një grupi të caktuar pyetjesh, ne ndoqëm të gjithë procesin e pasivimit të adresave, në mënyrë që krahas analizës bazë të materialit, të ndërtojmë një udhërrëfyes nëpër të cilin kalojnë të anketuarit në këto raste. Në këtë drejtim, synimi ishte që:

- të identifikohen shtigjet formale dhe joformale të hapave procedural në pasivimin e adresave;
- të vlerësojë kuptimin dhe prioritetet e secilit prej hapave të përmendur;
- të identifikojë kufizimet dhe përparësitë, me qëllim që të bëhen rekomandime për përmirësimin e të gjithë procesit të pasivimit të adresave.

Tabela e mëposhtme tregon strukturën bazë të të anketuarve me të cilët janë zhvilluar intervista të thelluara dhe diskutimet në grupe të fokusuar në tre lokacione:

	Qytetarët		Akterët politikë dhe organizatat politike	
	Burra	Gra	Burra	Gra
Medvegja	13	6	3	1
Bujanoci	2	/	7	1
Presheva	2	/	10	2
GJITHËSEJTË: 47				

Instrumentet e hulumtimit

Të udhëhequr nga ideja se udhëzuesi i intervistës është vendimtar në fokusimin e kërkimit, ne hartuam një pyetësor gjysmë të strukturuar. Pyetësi i lartpërmendur përmbante temat dhe pyetjet kryesore që synonte të mbulonte hulumtimi, megjithëse gjatë bisedës ne gjithmonë linim hapësirë që disa pyetje të anashkalohehin, modifikoheshin ose të futeshin pyetje të tjera, duke ndjekur rrjedhën e rrëfimit të të anketuarit. Pikërisht ky është avantazhi i një interviste të

thelluar gjysmë të strukturuar, e cila ofron fleksibilitet gjatë hulumtimit.⁵

I gjithë udhëzuesi i intervistës së thelluar përbëhet nga disa grupe pyetjesh: (i) karakteristikat demografike të të anketuarve; (ii) përvojat dhe sjelljet gjatë pasivizimit; (iii) opinionet dhe vlerësimet e pasivizimit; (iii) ndjenjat për këtë proces; (iv) njohja faktike e pasivimit; (v) dhe përvojat shqisore (çfarë kanë dëgjuar ose parë të anketuarit) rreth pasivimit.

Hulumtimi i proceseve të pasivizimit dhe formave të tjera të diskriminimit të shqiptarëve në jug të Serbisë nënkupton respektimin e standardeve të larta etike, me synimin për të mbrojtur njësoj të anketuarit dhe hulumtuesit. Hulumtimi u krye në atë mënyrë që të drejtat e individëve të përfshirë në procesin e hulumtimit të mbroheshin plotësisht, duke u udhëhequr nga parimi «mos bëj keq». Kjo qasje bazohet në krijimin e një mjedisi mbështetës që siguron përjashtimin e rreziqeve për të anketuarit ose siguron që rreziqet të mos jenë më të mëdha se ato që ata hasin në jetën e përditshme ose gjatë anketave rutinë. Para çdo interviste apo diskutimi në fokus grup, pjesëmarrësit u njohën me vetë hulumtimin, qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe normat e etikës dhe më pas nënshkruan një pëlqim me shkrim për të marrë pjesë në hulumtim. Gjithashtu, në asnjë rast informacionet personale për të anketuarit, të marra nga hulumtimi, nuk u shkëmbyen me autoritetet administrative, politike, policore, ushtarake apo gjyqësore. Anëtarët e ekipit hulumtues morën të gjitha masat për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të mbledhur. Të dhënat e mbledhura janë anonime, për të parandaluar mundësinë e zbulimit të informacioneve personal për pjesëmarrësit në hulumtim.

Duke marrë parasysh situatën shumë të ndjeshme në të cilën gjendet komuniteti shqiptar në jug të Serbisë, ekipi hulumtues i organizoi intervistat në vende që vetë të anketuarit i përcaktuan si të sigurta dhe adekuate. Të gjitha të dhënat e mbledhura janë përdorur ekskluzivisht për këtë projekt dhe përgatitjen e raportit, pa të dhënat personale të të anketuarve. Të dhënat e mbledhura do të ruhen në bazat e sigurta të të dhënave të organizatorëve të kërkimit dhe nuk do të përcillen askujt.

STRUKTURA DEMOKRAFIKE E TË ANKETUARËVE

TË ANKETUARIT

GJINIA:	Mashkull:	Femër:			
	37	10			
Qytetarë: 23	Aktor dhe aktivistë politikë: 24				
Diapazoni në moshë*:	18-30	30-50	50-65	> 65	
	1	7	6	9	
Arsimi:	Pa arsim formal	Shkolla fillore	Shkolla e mesme	Fakultet	
	5	6	4	8	
Njohja e gjuhëve:	Vetëm shqip	Vetëm serbisht	Srbisht në nivel të ulët	Rrjedhshëm, të dyja gjuhët	
	7	/	7	9	
Statusi punues:	I/e punësuar	I/e papunësuar	Pensionist/e	Ndihmë sociale	Punë të përkohëshme
	5	5	9	1	3

GJITHËSEJTË: 47

* te kategorizimi sipas moshës, të dhënat përkohjnë vetëm me qytetarët.

Paraqitja e strukturës demografike tregon se të anketuarit tanë, qytetarë që ballafaqohen me problemin e pasivizimit, janë kryesisht mbi 50 vjeç, pa ose me nivel më të ulët të arsimit formal dhe me njohuri të dobët të gjuhës serbe. Këta janë kryesisht pensionistë ose të papunë, ndërsa në një masë më të vogël ka të punësuar ose me punë të përkohshme, ndërsa një i anketuar është përfitues i ndihmës sociale. Në një masë më të vogël, janë të pranishëm të anketuarit me arsim të lartë dhe ata që flasin rrjedhshëm shqip dhe serbisht.

UDHËRRËFYESI

Udhërrëfyeti paraqet vizualizimin e fazave që kalon një individ në rastin e pasivimit të adresës dhe përbënë plotësimin e analizës tekstuale që pason atë. Duke pasur parasysh dallimet ekzistuese në procese, këtu prezantohet dy udhërrëfyetë - njëri i krijuar sipas kornizës ligjore, që tregon se si duhet të duket realisht procesi i pasivimit, dhe udhërrëfyetë tjetër i hartuar duke u bazuar në deklaratat e të anketuarve nga Bujanoci, Medvegja dhe Presheva, i cili paraqet model tipin ideal të përvojave të të anketuarve në këtë proces. Së fundi, do të paraqesim një udhërrëfyetë të tretë që krahason dy të mëparshmet, duke vënë në dukje lëshimet ekzistuese në rrespektimin procedurave ligjore.


Udhërrëfyeti sipas Ligjit mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin e qytetarëve



Me nenin 18 të ligjit parashihet qartë se si duket procesi i pasivizimit dhe cilat janë të drejtat dhe mundësitë e qytetarëve me adresa të pasivizuara. Para së gjithash, policia mund të kontrollojë nëse një qytetar jeton në adresën e regjistruar vetëm në bazë të kërkesës së gjykatës, autoriteteve apo organizatave të tjera, personave juridikë dhe fizikë. Nëse konstatohet se shtetasi nuk ndodhet në adresën e regjistruar, organi kompetent lëshon vendim për pasivizimin e adresës, ndërkohë qytetari ka afat prej 8 ditësh për të raportuar vendbanimin e tij aktual, përkatësisht vendqëndrimin. Në rast se nuk ka raportim brenda afatit të caktuar, policia i cakton shtetasit një adresë të re, përkatësisht: te partneri me lidhje martesore ose pa të, te prindi, institucionin ku është strehuar ose te qendra për punë sociale. Ndaj vendimit për adresën e caktuar, qytetari ka 8 ditë afat ligjor për t'u ankuar.




Në rast ankimimi, policia është e detyruar që sërish t'i vërtetoj faktet e banimit, përkatësisht të qëndrimit të përkohshëm në adresën e regjistruar dhe të nxjerrë një aktvendim të ri.

Udhërrëfyese sipas tipit ideal nga përvoja e të anketuarëve



Udhërrëfyese nëpër të cilën kalojnë qytetarët me adresa të pasivizuara është dukshëm i ndryshëm nga ajo e parashikuar në ligj. Zakonisht fillon kur një individ shkon në MPB për të rinovuar ose marrë dokumente të reja personale (p.sh. letërnjoftim, patentë shoferi, pasaportë). Më pas punonjësi i policisë e informon gojarisht se nuk ka adresë të regjistruar të vendbanimit. Duke qenë se për këtë rast mungojnë shpjegimet me shkrim, qytetarët nuk kanë mundësi të bëjnë

ankim për pasivizimin e adresës brenda afatit 8-ditor të parashikuar në ligj. Më tej, udhërrëfyesi zhvillohet në dy drejtime të mundshme. Në drejtimin e parë të mundshëm, qytetarët pyesin zyrtarët e policisë se cilat janë opsionet e tyre për zgjidhjen e çështjes së pasivizimit dhe marrin këshilla për të pritur vizita në terren nga punonjësit e policisë në adresën e shtëpisë së tyre, në muajt e ardhshëm. Qytetarët presin deri në 6 muaj për t’u vizituar nga zyrtarët policor në adresën e shtëpisë, ndërsa policia ose paraqitet disa herë ose nuk paraqitet fare. Në fund të këtij udhërrëfyesi, në rastet më të shpeshta qytetarët marrin aktvendim për pasivimin e sërishëm të adresës. Në një drejtim tjetër potencial, qytetarët vendosin të angazhojnë avokat dhe inicojnë kontest në gjykatë. Më pas inicohet procedura e kontestit administrativ dhe për shkak të kohëzgjatjes së saj – ndonjëherë mund të zgjasë edhe dy vjet – qytetarët heqin dorë nga ky proces dhe mbeten me adresa të pasivuara.

Ligji	Kërkesa për verifikim	Verifikimi i faktit të	Paraqitja e vendbanimit në afat prej 8 ditësh	Aktvendimi mbi pasivizimin	Ankesa	Verifikimi i sërishëm i faktit të banimit	Aktvendimi i ri
Të anketuarit	/	/	/	Komunikimi verbal mbi pasivizimin	Interesimi mbi të drejtat vetanake ose ushtrimi i padisë	Pritja që policia ta bëjë verifikimin ose përfundim i kontestit	Pasivizimi
							
							
							

Paraqitja krahasuese e udhërrëfyeseve

Paraqitja krahasuese e udhërrëfyeseve, ai i parashikuar në ligj dhe tjetri nëpër të cilën kalojnë të anketuarit, tregon qartë lëshimet themelore që ndodhin gjatë pasivimit të adresave të qytetarëve dhe tregon se nuk rresepktohet pothuajse asnjë segment i udhërrëfyesisë të cilin e parasheh ligji. Në rastin e të intervistuarve tanë, kryesisht mungon zbatimi i tri pjesëve të para të udhërrëfyesisë, ndërsa e treta - se

adresat e tyre janë pasivuar – ata mësojnë për këtë gojarisht nga zyrtarët policor, gjë që është në kundërshtim me ligjin. Segmenti i katërt i udhërrëfyesit, ankimimi, mungon kryesisht për shkak të moszbatimit të procedurave të mëparshme, për pasojë qytetarët humbasin afatin 8-ditor të ankimimit të parashikuar me ligj. Dy segmentet e fundit janë më afër asaj që parashikon Ligji. Riverifikimi i adresës pas ankesës parashikohet me ligj, megjithëse nuk është e përcaktuar qartë se sa duhet të zgjasë ky verifikim. Në fund të udhërrëfyesit është miratimi i një aktvendimi të ri, i cili është në përputhje me ligjin, por përvojat e të anketuarve tanë tregojnë se edhe pas verifikimeve të përsëritura adresat mbeten të pasivizuara. Fakti që kemi evidentuar një numër të madh të të anketuarve, adresat e të cilëve u është pasivizuar përgjithmonë, në kuptimin që nuk kanë vendbanim, përkatësisht vendqëndrim, tregon shkelje të Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve, ku thuhet se autoriteti kompetent “... sipas detyrës zyrtare, do ta pasivizoj adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin, në rast të ndërprerjes së shtetësisë së Republikës së Serbisë ose vdekjes së shtetasve” (neni 18, paragrafi 6). Me fjalë të tjera, adresat mund të pasivizohen vetëm nëse dikush pushon së qeni shtetas i Republikës së Serbisë ose nëse ai ndërron jetë, përndryshe çdo shtetas i Republikës së Serbisë duhet të ketë, adresë të vendbanimi ose vendqëndrimin, e cila duhet t’i caktohet madje edhe zyrtarisht.

NJË PREZENTIM HISTORIK DHE POLITIKË I LUGINËS SË PRESHEVËS

Presheva, Bujanoci dhe Medvegja janë komuna të pazhvilluara në jug të Serbisë me një popullsi të përzier shqiptare, serbe dhe rome.⁶ Zona kufizohet me Kosovën në jugperëndim dhe me Republikën e Maqedonisë në jug. Përbërja demografike,

6 Sipas rezultateve të Regjistrimit të vitit 2022, struktura demografike e komunave të përmendura duket kështu: 1) Medvegja ka 6.360 banorë, prej të cilëve: 4.927 serbë, 905 shqiptarë dhe 149 romë; 2) Bujanoci ka 41.068 banorë, prej të cilëve: 10.467 janë serbë; 25.465 shqiptarë dhe 3.532 romë, 3) Presheva ka 33.449 banorë, prej të cilëve: 1.607 serbë, 31.340 shqiptarë dhe 219 romë.

pozita e rajonit dhe moszhvillimi i tij e kanë bërë këtë zonë të paqëndrueshme, në të cilën në mënyrë specifike janë përplasur rrethanat ekzistuese politike, të sigurisë dhe të tjera në Serbi, Kosovë dhe më gjerë.⁷

Të drejtat themelore të njeriut dhe të pakicave të shqiptarëve janë shkelur vazhdimisht gjatë regjimit të Slobodan Millosheviqit. Diskriminimi në arsim, punësim, informim dhe fusha të tjera u intensifikua në fund të viteve '80-ta. Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Serbisë nga viti 1990, dhe më pas një sërë ligjesh që synonin forcimin e pushtetit qendror, prekën kryesisht vetëqeverisjen lokale. Sa për ilustrim, në komunën e Preshevës që nga viti 1990, partitë shqiptare gjithmonë kanë fituar pushtetin lokal, por nuk kanë pasur mundësi të ndikojnë në përmirësimin e të drejtave kolektive të pakicës shqiptare. Deri në intervenimin e Paktit Veriatlantik (NATO) në vitin 1999, përveç diskriminimit sistematik, autoritetet ushtronin edhe lloje të tjera presionesh (largime nga puna, gjyqe politike, ndalime të botimit të revistave).⁸

Gjatë bombardimeve të NATO-s, pati shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe represion të hapur nga formacionet paraushtarake, ushtria dhe policia. Vetëm në territorin e Komunës së Preshevës, gjatë gjendjes së luftës në vitin 1999, në rrethana të pasqaruara janë vrarë 11 shqiptarë. Rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut (vrasje, keqtrajttime dhe grabitje) në të tri komunat ishin të ngjashme me ato që kanë ndodhur në të njëjtën kohë në Kosovë.⁹ Sa i papërgjegjshëm është qëndrimi i shtetit të Serbisë ndaj shkeljeve të të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, dëshmon deklarata e kryeministres Ana Brnabiq, e datës 29 gusht 2023, në të cilën thekson se “ Shqiptarët në jug të Serbisë qendrore kanë shtet ligjor, kanë të drejta të njeriut, është e pamundur që dikush të çëllojë një shqiptar në Preshevë apo Bujanoc dhe të mos jetë përgjegjës për këtë”.¹⁰

7 Fondi për të Drejtën Humanitare, Shqiptarët në Serbi: Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, Beograd, 2003., f. 3: <https://www.hlc-rdc.org/images/stories/publikacije/Albanci-u-Srbiji.pdf>;

8 Po aty;

9 Po aty.

10 *Info Vranjske*, “Postoje li ljudska prava na jugu Srbije: Brnabić o Albancima u Preševu i Bujanovcu”, 29.8.2023. <https://infovranjske.rs/postoje-li-ljudska-prava-na-jugu-srbije-brnabic-o-albancima-u-presevu-i-bujanovcu/>.

Sipas raportit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Bujanoc, për shkak të konflikteve të armatosura dhe frikës për sigurinë, popullata shqiptare nga komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në tri raste kanë braktisur shtëpitë e tyre. Vala e parë ishte gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, kur rreth një e treta e shqiptarëve u larguan nga zona. Vala e dytë e emigrimit ndodhi në vitet 2000-2001.; ndërsa vala e tretë e emigrimit nga Presheva dhe Bujanoci në Kosovë rezultoi me rreth 14.000 të shpërngulur nga kjo zonë.¹¹

Kthimi i shqiptarëve të shpërngulur filloi pas përfundimit të konflikteve të armatosura. Kthimit i parapriu vizita të organizuara të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në qershor 2001. Ndihma e organizatave ndërkombëtare në rindërtimin e shtëpive të dëmtuara dhe sferave të tjera të jetës ishte e një rëndësie të madhe. Organizatat ndërkombëtare vlerësojnë se pas përfundimit të konfliktit janë gjithsej rreth 5.300 shqiptarë të kthyer në komunat e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.¹²

Në raportin e lartpërmendur të Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Bujanoc nga viti 2016, thuhet se shqiptarët që kanë mbetur në Kosovë, numri i të cilëve zyrtarisht nuk dihet, nuk janë të regjistruar në Kosovë si persona të zhvendosur apo refugjatë dhe si të tillë nuk kanë asnjë dokumentacion. Në Serbi ata trajtohen si “persona ligjërisht të padukshëm” dhe ndaj tyre kryhet procesi i pasivizimit të vendbanimit.¹³ Kjo popullatë, edhe pse më e afërta me rrezikun apatrid (pashtetësisë), është vetëm një nga nëngrupet e qytetarëve të pasivuar që kanë apo kanë pasur adresë të vendbanimit në komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës.

Pra, edhe pse shtetas të Serbisë, ku janë edhe taksapagues, shqiptarët dalëngadalë mbeten pa dokumente të vlefshme personale dhe nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sociale, as të drejtën e votës. Në kërkimin e të drejtave të tyre civile, shqiptarët në jug të Serbisë mbështeten në Planin për zgjidhjen paqësore të krizës në hapësirën e jugut të Serbisë qendrore ose, siç e quajnë shqiptarët, «Marrëveshja

11 Këshilli për të drejtat e njeriut – Bujanoc, „(Mos)implementimi i marrëveshjeve të Qeverisë lidur me jugun e Serbisë, Bujanoc“, 2016., f. 50-51: <https://chris-network.org/wp-content/uploads/2016/07/Neimplementacija-vladinih-sporazuma-u-vezi-sa-jugom-Srbije.pdf>.

12 Po aty.

13 Po aty, f. 52.

Konçul» (2001) , me të cilën Qeveria Federale e RFJ-së mori përsipër të realizojë të drejtat e shqiptarëve. Kjo u pasua me marrëveshjen e vitit 2007 për riorganizimin e Trupit Koordinues për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe integrimin e shqiptarëve në institucionet shtetërore dhe publike, dhe me Planin shtatëpikësh” nga viti 2013.¹⁴

POPULLËSIA E BUJANOCIT, PRESHEVËS DHE MEDVVEGJËS

Që nga viti 1981, pakica shqiptare në Serbi nuk ka marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, kështu që rezultatet e asaj kohe nuk mund të jenë adekuate me gjendjen aktuale. Regjistrimi i popullsisë i kryer në territorin e ish-Jugosllavisë në vitin 1981, nga Enti federativ për stsatistika, është një nga të fundit që ka ofruar të dhëna të sakta për numrin e banorëve në Serbi. Sipas atij regjistrimi, komuna e Bujanocit kishte 46.689 banorë. Nga kjo, shqiptarët përbënin pak më shumë se 55% (25.848), serbët rreth 34% (15.914), dhe romët afër 9% (4.130). Komuna e Preshevës kishte 33.948 banorë. Shumica, mbi 85% (28.961) ishin shqiptarë, mbi 12% (4.204) serbë dhe mbi një për qind (433) romë. Nga 17.219 banorë të komunës së Medvegjës, serbë dhe malazezë ishin rreth 65% (11.354), shqiptarë rreth 32% (5.509) dhe romë rreth gjysmë për qind (83).¹⁵

Regjistrimi i përgjithshëm i bërë në vitin 1991 u bojkotua nga shqiptarët në Kosovë sikur edhe në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Vlerësimet e numrit të popullsisë shqiptare janë bazuar në regjistrimin e vitit 1981. Sipas këtyre informacioneve, në komunën e Bujanocit kishte 49.238 banorë, prej të cilëve rreth 30% ishin serbë (14.660), 60% ishin shqiptarë (29.588) dhe pak më pak se nëntë për qind ishin romë (4.408). Është vlerësuar se në komunën e Preshevës jetonin 38.943 banorë, prej të cilëve rreth 90% ishin shqiptarë (34.992), 8% serbë (3.206), dhe 1.29% romë (505).

14 Po aty.

15 Këshilli për të drejtat e njeriut – Bujanoc, „(Mos)implementimi i marrëveshjeve të Qeverisë lidur me jugun e Serbisë, Bujanoc“, 2016., f. 9.: <https://chris-network.org/wp-content/uploads/2016/07/Neimplementacija-vladinih-sporazuma-u-vezi-sa-jugom-Srbije.pdf>

Enti federativ për statistika nuk ka publikuar vlerësime për komunën e Medvegjës, por vetëm rezultatet e regjistrimit, sipas të cilave në këtë komunë ka pasur 13.368 banorë, prej të cilëve 9.205 serbë dhe malazezë dhe 3.832 shqiptarë.¹⁶

Regjistrimi i parë i popullsisë të cilit i është përgjigjur pakica shqiptar në jug të Serbisë ishte regjistrimi i vitit 2002, i cili ishte paraparë me “Planin e Çoviqit”.¹⁷ Ky regjistrim është, ndër të tjera, shumë i rëndësishëm për pakicën shqiptare, sepse ka mundësuar që shqiptarët të integrohen në mënyrë proporcionale në strukturat e pushtetit lokal në komunën e Bujanocit, në zgjedhjet e parakohshme lokale të vitit 2002, të mbajtura menjëherë pas regjistrimit.¹⁸

Pakica shqiptare e bojktoi regjistrimin e popullsisë të bërë në vitin 2011, sepse, sipas pohimeve të përfaqësuesve politikë shqiptarë nga jugu i Serbisë, Enti republikan i atistikave nuk ka dhënë garanci se regjistrimi i popullsisë do të përfshijë ata banorë të komunës së Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës që u larguan nga këto komuna gjatë vitit 1999, gjegjësisht gjatë dislokimit të forcave të sigurisë të RFJ-së, që ishin tërhequr nga Kosova në zonën e këtyre komunave. Sipas regjistrimit të lartpërmendur të vitit 2011, zyrtarisht janë regjistruar 5805 shqiptarë. Një fakt interesant pas regjistrimit të vitit 2011 është se numri i shqiptarëve në Serbi, duke përfshirë jugun e Serbisë, është rritur; në Vojvodinë numri i shqiptarëve u rrit me 556, nga 1.695 në 2.251, në Beograd u ul me 240, nga 1.492 në 1.252 dhe në pjesën tjetër të Serbisë Qendrore u rrit nga 865 në 1.119.¹⁹

Ministria e Administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, në bashkëpunim me deputetët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe përfaqësuesit e këtyre

16 Këshilli për të drejtat e njeriut – Bujanoc, „(Mos)implementimi i marrëveshjeve të Qeverisë lidur me jugun e Serbisë, Bujanoc“, 2016., f. 9.: <https://chris-network.org/wp-content/uploads/2016/07/Neimplementacija-vladinih-sporazuma-u-vezi-sa-jugom-Srbije.pdf>

17 Plani i Çoviqit është marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të RFJ-së dhe Qeverisë së Serbisë dhe përfaqësuesve politikë të shqiptarëve të Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës me emrin “Programi për zgjidhjen e krizës në rrethin e Pçinjës” 1 shkurt. , 2001.: <https://www.peaceagreements.org/generate/AgreementPDF/1431>;

18 Këshilli për të drejtat e njeriut – Bujanoc, „(Mos)implementimi i marrëveshjeve të Qeverisë lidur me jugun e Serbisë, Bujanoc“, 2016., f. 8.: <https://chris-network.org/wp-content/uploads/2016/07/Neimplementacija-vladinih-sporazuma-u-vezi-sa-jugom-Srbije.pdf>

19 Po aty, f. 9.

komunave, në qershor të vitit 2015 u pajtuan për metodologjinë e përdorur për vlerësimin e numrit të banorëve në jug të Serbisë. U angazhua një ekip ekspertësh ndërkombëtarë nga Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Beograd, në një takim të kryesuar nga OSBE. Të dhënat që ata kanë fituar tregojnë këto vlerësime për numrin e banorëve të secilës komunë: Presheva 29.600, Bujanoci 38.300, Medvegja, 7.400.²⁰

Sipas regjistrimit të bërë në vitin 2022, në Bujanoc jetojnë gjithsej 41.068 qytetarë, prej të cilëve 10.467 janë serb, ndërsa 25.465 janë shqiptarë. Në Preshevë numri i përgjithshëm i banorëve është 33.449, ku janë 31.340 shqiptarë, ndërsa 1.607 janë shtetas me përkatësi serbe. Në Medvegjë gjithsej 6.360 banorë, prej të cilëve 4.927 janë shtetas të nacionalitetit serb dhe 905 janë shtetas me përkatësi shqiptare.²¹ Aktivisti Arben Ferati nga Medvegja dhe Lirona Zhuka, përfaqësuese e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Medvegjë, deklarojnë se në fshatrat ku jetojnë shqiptarët, si dhe në disa vendbanime të përziera etnike, gjatë regjistrimit të popullsisë kanë marrë pjesë 3000 shqiptarë nga Medvegja, por për shkak të gabimeve procedurale gjatë regjistrimit, ky numër u reduktua në rreth 900. Lirona Zhuka thotë se një nga kryeshefët e komunës së Medvegjës ka penguar procesin e regjistrimit duke dërguar regjistruesit shqiptar (gjithsej tre persona për komunën e Medvegjës) në fshatrat me shumicë serbe dhe regjistrues serb, të cilët nuk e dinin gjuhën shqipe, në fshatrat me shumicë shqiptare. Po ashtu, ata thonë se regjistrimi në këtë komunë është vonuar dhe se përkundër premtimit se qytetarët me adresa të pasivuar do të mund të paraqiten në regjistrim, nuk ka ndodhur kështu.²²

Manipulimi me numrin zyrtar të banorëve shqiptarë në Medvegjë, si dhe pasivizimi i adresave, ndikon drejtpërdrejt në derogimin e mundshëm të së drejtës për dygjuhësi në organet e vetëqeverisjes lokale. Duke qenë se numri zyrtar i shqiptarëve në Medvegjë, sipas regjistrimit të vitit 2022, ka rënë nën 15% të popullsisë, pra

20 Po aty, f. 12,

21 Enti republikan statistikor, Regjistrimi i Popullsisë 2022 - Popullsia sipas përkatësisë kombëtare, përditësuar më 27.4.2023.: <https://data.stat.gov.rs/Home/Result/3104020102?languageCode=sr-Cyrl>.

22 Intervistë e Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në Medvegjë, 16.7.2023.

14,22%, përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, si gjuhë e pakicës kombëtare, në këtë komunë praktikisht është hequr.²³

GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

Bazuar në 47 intervista të thelluara, të realizuara me qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve, partive politike, anëtarë të organizatave lokale të shoqërisë civile, si dhe qasjes në më shumë se 60 aktvendime për pasivizimin e adresave, ekipi hulumtues i Nismës Rinore për Të Drejtat e Njeriut erdhën në këto gjetje kryesore rreth sjelljes diskriminuese të MPB-së së Serbisë:²⁴

Ligji për vendbanim dhe vendqëndrim është shkelur nga Ministria e Punëve të Brendshme, para së gjithash në komunën e Medvegjës, e më pas në masë më të vogël në komunën e Bujanocit dhe Preshevës, në këto mënyra:

- Kur mungon aktvendimi me shkrim për pasivimin, dhe qytetarët nuk janë informuar prej disa vitesh për faktin se adresa e tyre është pasivuar, por e mësojnë verbalisht dhe pa shpjegime të qarta për procesin e ankimimit apo të drejta të tjera të garantuara me ligj.
- Diapazoni i viteve që kalojnë nga pasivizimi deri në marrjen e informacioneve verbale, në shumicën e rasteve, është nga 3 deri në 5 vjet ndërkaq 72% e qytetarëve të anketuar nuk kanë marrë aktvendim për pasivizimin e adresave. Në këtë mënyrë është shkelur neni 18, paragrafi 2 i të njëjtit ligj.
- Në rastet kur policia merr aktvendim për pasivizim, këto aktvendime shpesh afishohen në tabelat e shpalljeve të institucioneve, ndërkohë që nuk u dërgohen qytetarëve ose dërgohen me vonësë. Në këtë mënyrë është shkelur neni 18, paragrafi 3 i të njëjtit ligj.
- Në rastet kur policia nxjerr aktvendim për pasivizimin, arsyetimi nuk shpjegon nëse shtetasi përmbushë ndonjë nga katër kushtet për regjistrimin

23 Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit, ("Sl. glasnik RS", br. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/2005 - dr. zakon, 30/2010, 47/2018 i 48/2018 - ispr.). član 11: https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_sluzbenoj_upotrebi_jezika_i_pisama.html.

24 Sipas të dhënave që Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka marrë nga një burim, shqiptarët përbëjnë 29.9% të forcave policore në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

e adresës (në bazë të banimit të tij të përhershëm, nëse plotësohen kushtet e tjera të përcaktuara me ligj; vendbanimi i bashkëshortes ose partnerit jashtëmartesor, vendbanimi i prindërve të tij, institucioni ku është strehuar në kohë të pacaktuar ose qendra për punë sociale në territorin e së cilës ndodhet, me kërkesën e qytetarit në atë ent ose qendër që adresa e tij do të jetë në adresën të entit ose qendrës). Në këtë mënyrë shkelet neni 11 i të njëjtit Ligj dhe neni 2 i Ligjit për letërnjoftime.

- Në rastin kur policia nuk mund të përcaktojë vendbanimin e shtetasve të pakicës shqiptare, anashkalohet procedura e përcaktimit të vendbanimit, e cila do t'u mundësonte qytetarëve të përfitojnë të drejtën e letërnjoftimit, në bazë të vendqëndrimit deri në dy vjet. Në këtë mënyrë është shkelur neni 17 i të njëjtit ligj, i cili në rast të mospërcaktimit të vendbanimit, i lë mundësinë policisë që me aktvendim të përcaktojë vendqëndrimin e shtetasve, duke u mundësuar kështu qytetarëve të drejtën e letërnjoftimit për një periudhë dy vjeçare.

Në bazë të dëshmisë së dhjetë të intervistuarve, policia i ka udhëzuar ata që të raportojnë adresën në një komunë tjetër në Serbi ose tek autoritetet e përkohshme të Serbisë në Kosovë, duke kërkuar edhe ryshfet në shumë prej disa mijëra eurosh. Në këtë mënyrë shkelet neni 39 i Kushtetutës, i cili garanton lirinë e lëvizjes dhe të banimit për të gjithë qytetarët e Republikës së Serbisë.

Në 80% të rasteve, qytetarët e pasivuar janë fshirë nga lista e zgjedhësve për zgjedhjet lokale dhe/ose parlamentare. Në këtë mënyrë ata u penguan të ushtrorjnë të drejtën e votës aktive dhe pasive, duke shkelur nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë.

Popullsia e qytetarëve të pakicës kombëtare shqiptare, të cilëve u është pasivuar adresa në mënyrë arbitrare, mund të klasifikohet në katër grupe:

1. individët që punojnë herë pas here jashtë vendit ose kanë marrë pension jashtë vendit (këta janë kryesisht ata që shkojnë në vendet e Evropës Perëndimore për punë tre mujore);
2. ata që punojnë në Kosovë;
3. studentët që studiojnë në Kosovë;
4. qytetarë apo veprimtarë të angazhuar politikisht nga Lugina e Preshevës;

Dy indikatorë bazë për keqpërdorimin e Ligjit për vendbanim dhe vendqëndrimin e qytetarëve janë të dhënat jokonsistente, mbi pasivizimin e qytetarëve në Luginën e Preshevës, të paraqitura nga përfaqësuesit e shtetit serb në vitet e fundit, si dhe zvogëlimin e numrit të zgjedhësve të regjistruar në listën zgjedhore në Medvegje.

Kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, më 24 shkurt 2020, ka dërguar kërkesë në administratën policore në Leskoc, për marrjen e të dhënave mbi numrin e qytetarëve të pasivuar në komunën e Medvegjës, që nga fillimi i zbatimit të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin e qytetarëve. Koloneli i policisë dhe shefi i DP-së në Leskoc, Tomislav Iliq, më 13 prill të po këtij viti i ka kthyer përgjigje, ku thuhet se stacioni policor në Medvegje, në periudhën prej 29 nëntor 2011. deri më 12.03.2020., ka pasivizuar adresat e 4174 qytetarëve.²⁵

Si një nga arsyet kryesore për pasivizimin e adresave në Medvegje, koloneli Iliq thekson: “Pas përditësimit të evidencës së rrugëve dhe numrave të shtëpive, si dhe kadastrës së patundshmërive në vetëqeverisjet lokale, është konstatuar se më nuk ekzistojnë një numër i madh i objekteve, në adresat ku qytetarët kanë regjistruar vendbanimin”.²⁶

Në të njëjtin dokument thuhet se “...iniciativa për pasivizim në të shumtën e rasteve ka ardhur nga komuna e Medvegjës...”, si dhe se “...një numër jashtëzakonisht i vogël i qytetarëve janë ankuar kundër aktvendimeve për pasivim. ...” që, siç thuhet më tej në dokument, është një konfirmim se ata qytetarë nuk jetojnë më në adresat që janë pasivuar.

Në seancën e Kuvendit Popullor të Serbisë, të mbajtur në fund të nëntorit 2020, deputeti Shaip Kamberi nga Partia për veprim demokratik i ka dorëzuar kërkesë ministrit të Punëve të Brendshme, Aleksandar Vulin, për marrjen e informacionit për numrin e qytetarëve të pasivuar në komuna e Medvegjës (Medvegja si qendër administrative, Banja e Sijarinës, Tupalla, Svirca, Grbavci, Banja e Poshtme, Banja e vjetër, Sijarina, Gjylekari, Llapashtica dhe Kapiti) gjatë viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020.²⁷

25 Një kopje e dokumentit zyrtar gjendet në arkivin e Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut.

26 Po aty.

27 Dokument i marrë nga deputeti Shaip Kamberi. Arkivi i Nismës e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut.

Në përgjigjen e tij të datës 09.12.2020, drejtuar deputetit Kamberi, ministri Vulin e ka njoftuar deputetin Kamberi se numri i personave të pasivizuar nga 1 janari 2017 deri më 26 nëntor 2020 për këto zona të banuara në komunën e Medvegjës është 1751. Ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme, në përgjigjen e tij drejtuar Kamberit, ka shpjeguar se qasja në të drejtat elementare civile, përkatësisht, dokumentet personale, sigurimet shëndetësore dhe sociale dhe arsimi, nuk u pengohet qytetarëve me adresë të pasivizuar të vendbanimit, sepse ata mbeten shtetas të Republikës së Serbisë dhe kanë të gjitha të drejtat që dalin nga ai status.²⁸

Sipas hulumtimit të kryer disa muaj më vonë nga Flora Ferrati Sassenmayer, deputeti Kamberi i ka bërë të njëjtën pyetje ministrit Vulin, por për periudhën 2011-2017. Sipas përgjigjes së dytë të ministrit Vulin, nuk ka të dhëna për numrin e qytetarëve të pasivuar. Po ashtu, në të njëjtin hulumtim thuhet se zyrtarët shtetërorë serbë në mars të vitit 2021 kanë publikuar të dhëna të reja mbi pasivizimin. Me kërkesë të Viola von Cramon-Taubadel, deputete e Parlamentit Evropian dhe raportuese për Kosovën, vetëm pak javë para miratimit të raportit të Komisionit Evropian për progresin e Serbisë, ambasadori serb ua dorëzoi deputetëve të Parlamentit Evropian një dokument me titull : «Adresa të pasivuara në Serbi» me këto të dhëna: a) 1782 raste për komunën e Medvegjës, b) 570 për Bujanocin dhe c) 92 për Preshevën.²⁹

Në bazë të kërkesës për informata me rëndësi publike, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka kërkuar nga administratat rajonale policore të dhëna për numrin e qytetarëve të pasivizuar për të gjitha komunat në Serbi, në periudhën prej 1.1.2012. deri në 1.6. 2023, sipas vitit kur është miratuar aktvendimi për pasivimin. MPB-ja nuk ka dorëzuar numrat për komunën e Medvegjës për vitet 2020, 2021, 2022 dhe për periudhën deri më 1 qershor 2023. Prandaj, as këto të dhëna nuk japin pasqyrë të plotë të numrit të adresave të pasivizuara të qytetarëve në Luginën

28 Po aty.

29 Flora Ferrati-Sachsenmaier. 2023. "Serbia's Passivization Policy Towards the Albanian Minority: How Southern Serbia is Being Turned Ethnically Serbian". Max-Planck-Institut zur Erforschung multireligiöser und multiethnischer Gesellschaften, Max Planck Institute for the Study of Religious and Ethnic Diversity, p. 18: <https://www.mmg.mpg.de/1156996/wp-23-01>;

e Preshevës. Meqenëse MPB-ja nuk ka ofruar të dhëna për numrin e rasteve të qytetarëve të pasivuar për tre vitet e fundit, as kopje të aktvendimeve të miratuara në administratën policore në Leskoc dhe Vranjë, nga dekada e kaluar, e gjithë kjo tregon mungesën e transparencës së tyre dhe ngre dyshime për keqpërdorimin e mundshëm të lligjit.

Mirëpo, duke krahasuar numrin e banorëve dhe rastet e pasivizimit në Medvegjë me komunat tjera në jug të Serbisë, të cilat nuk janë pjesë e Luginës së Preshevës, krijohet përshtypja se kjo komunë është ndër më të prekurat kur bëhet fjalë për zbatimin e procesit të pasivimit të adresave. Në komunat në jug të Serbisë, ku popullsia serbe është dominuese, përqindja e rasteve të pasivizuara nuk e kalon 1% të popullsisë së përgjithshme, ndërsa në rastin e Medvegjës, për periudhën 2015-2019, është 21.2%.

Tabela 1: Statistikat e numrit të qytetarëve të pasivuar për komunat e Luginës së Preshevës sipas përgjigjeve nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, të dërguara në gusht të vitit 2023 në adresë të Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut.

Viti/Komuna	Medvegjë	Bujanoc	Preshevë
2012.	9	2	0
2013.	13	60	19
2014.	4	127	26
2015.	74	150	10
2016.	820	102	11
2017.	120	56	5
2018.	59	98	5
2019.	496	97	31
2020.	/	61	71
2021.	/	73	50
2022.	/	45	135
2023. (pesë muajt e parë të vitit)	/	9	67
Numri i përgjithshëm	1595	880	430

Tabela 2. Paraqitja krahasuese e komunave: Përqindja e të pasivizuarëve në raport me numrin e banorëve

Komuna	Numri i banorëve sipas regjistrimit të vitit 2011/ përkatësisht., vlerësimit të regjistrimit nga viti 2015	Numri i rasteve të pasivizimit nga viti 2015 deri në vitin 2019 sipas të dhënave të marra nga MPB-ja e Serbisë	Përqindja e personave të pasivuar në raport me numrin e banorëve
Bojnik	11 104	29	0,26 %
Vladiçin Han	20 871	27	0,12 %
Leban	22 000	11	0,05 %
Medvegjë	7 400	1569	21,2 %

Një tregues tjetër i keqpërdorimit të mundshëm të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin është edhe ndryshimi i listës zgjedhore në komunën e Medvegjës. Nga bisedat e ekipit hulumtues me përfaqësuesit e komunës së Bujanocit dhe Preshevës, del se në këto komuna ende nuk janë vërejtur ndryshime të tilla drastike, por ka shqetësim për rastin e Medvegjës.³⁰ Sipas një dokumenti jozyrtar, të cilin ekipi hulumtues e ka marrë nga një burim anonim³¹, gjatë vizitës në Medvegjë, numri i përgjithshëm i zgjedhësve në listën zgjedhore të komunës së Medvegjës, në zgjedhjet lokale të mbajtura në shtator 2015, ishte 10.456 votues. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në listën zgjedhore të komunës së Medvegjës për zgjedhjet lokale të prillit 2022 ishte 6.147 votues.³²

Sipas prezentimit të bërë nga Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale, del se numri i zgjedhësve - të regjistruar në listën zgjedhore në komunën e Medvegjës për datën 23 korrik 2023, është 6.114 persona.³³ Diferenca në listën zgjedhore të vitit 2015 dhe 2022 është 4309 ose 41,2% më pak votues në

30 Intervistë nga Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut

31 Burimi ka mbetur anonim për arsye sigurie.

32 Kopja e dokumentit gjendet në arkivin e Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut;

33 Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale, Pasqyra e numrit të zgjedhësve - gjendja më 23.7.2023. : <https://upit.birackispisak.gov.rs/PregledBrojaBiraca;>

listën zgjedhore të vitit 2022. Shumica dërrmuese e votuesve (3370 ose 78,2% e të gjithë votuesve të hequr), të cilët nuk ishin përfshirë në listën zgjedhore, vijnë nga vendbanimet me shumicë shqiptare në komunën e Medvegjës.

RASTET NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Një numër i vogël i qytetarëve me adresa të pasivuara kanë mundësi që ta kthejnë të drejtën e vendbanimit me ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e më pas me ngritjen e kontestit në gjykatën administrative dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë. Ekipi hulumtues i Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka marrë vesh për procedurën në Gjykatën Kushtetuese të iniciuar nga Safet Demiroviq, për shkak të keqpërdorimit të procesit të pasivimit të adresës. Gjithashtu, gjatë vizitës në terren në Bujanoc, ekipi hulumtues ka ndihmuar Teuta Fazliun nga Bujanoci, pas refuzimit të ankesës së saj në Gjykatën Administrative, të marrë mbrojtje gjyqësore duke u ankuar në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë, duke e iniciuar këtë proces me ndihmën e një avokati, në gusht 2023.

Safet Demiroviq

Safet Demiroviq më 14.08.2019., teksa ka shkuar në Stacionin policor në Medvegjë, për të marrë certifikatën e armës, ka marrë vesh, krejt rastësisht, se i ishte pasivuar adresa ku jetonte që nga lindja. Nuk i është dorëzuar aktvendimi për pasivizimin, gjë që e ka qenë pengesë për ushtrimin e ankesës. Në të vërtetë, Demiroviq jeton në një ekonomi të madhe familjare, e cila përbëhet nga disa ndërtesa dhe në të cilën dikush nga anëtarët e familjes është i pranishëm gjatë gjithë kohës. Përveç kësaj kjo familje ka edhe video mbikëqyrje. Asnjë kamera e vëzhgimit nuk kishte regjistruar ardhjen e ndonjë oficeri policie, as gjatë tentativës së supozuar të dorëzimit, as gjatë kontrolleve të supozuara për verifikimin e vendbanimit. Krahas pronësisë mbi shtëpinë familjare, të përbërë nga disa ndërtesa, Demiroviq është edhe pronar dhe drejtor i një kompanie afariste në Banjë të Sijarinës, me seli në adresën e shtëpisë së përmendur familjare. Kjo kompani është aktive, i kryen aktivitetet e saj, ndërsa Demiroviq është drejtor i punësuar, i cili paguan rregullisht

taksa dhe kontribute. Pas vendimit të Gjykatës Administrative³⁴ të Departamenti në Nish, në mesin e vitit 2021, Safet Demiroviq autorizoi një avokat dhe parashtroi ankesë kushtetuese në të njëjtin vit, ndërsa vendimi pritet në fund të vitit 2023.

Teuta Fazliu

Teuta Fazliu ka lindur në Vranjë dhe jeton me prindërit e saj në Bujanoc. Ajo është e punësuar në Prishtinë, ndërsa më parë ishte aktive politikisht në Kosovë. Në mars të vitit 2020, vetëm dy ditë para shtetrrrethimit për shkak të epidemisë së koronavirusit, Teuta Fazliu ka ardhur në Bujanoc dhe ka qëndruar gjatë gjithë kohës gjatë orës policore të shkaktuar nga gjendja e jashtëzakonshme. Por në vendimin e Gjykatës Administrative thuhet se policia ka qenë në adresën e Teutës më 9 prill 2020. Megjithatë, Teuta ka dëshmi se për arsye shëndetësore, më 14.04.2020. i është nënshtruar kontrollit mjekësor në Vranjë. Në maj të vitit 2020, rreth orës 13:00, Teuta mori një ftesë nga postieri në orën 13.00, që po atë ditë të paraqitej në stacionin policor në Bujanoc, por në orën 10:00, të cilën edhe e bëri.³⁵ Teuta edhe më tutje jeton shumicën e vitit në Bujanoc.

KATALOGU I TË DREJTAVE POTENCIALISHT TË SHKELURA

- E drejta për mbrojtjen e pakicave kombëtare nga neni 14 i Kushtetutës: Republika e Serbisë mbron të drejtat e pakicave kombëtare. Shteti garanton mbrojtje të veçantë për pakicat kombëtare për arritjen e barazisë së plotë dhe ruajtjen e identitetit të tyre.
- Është shkelur e drejta për të ndaluar diskriminimin ndaj pakicave kombëtare nga neni 76 i Kushtetutës:
- Pjesëtarëve të pakicave kombëtare u garantohet barazia para ligjit dhe mbrojtja e barabartë ligjore.

34 Aktgjykimi i Gjykatës Administrative, departamenti në Nish, nr P - 4 U – 6455/20;
35 Aktgjykimi i Gjykatës Administrative, departamenti në Nish, nr P - 9 U – 21675/20;

- Konkretisht, duke iu pasivizuar qytetarëve adresën e vendbanimit, ekskluzivisht për qytetarët e pakicës kombëtare shqiptare, hiqet e drejta e votës. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta për të ndaluar diskriminimin nga neni 21 i Kushtetutës:

- Të gjithë janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit. Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Ndalohet çdo diskriminim, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, mbi çdo bazë, dhe veçanërisht në bazë të racës, gjinisë, kombësisë, origjinës sociale, lindjes, fesë, bindjeve politike ose të tjera, statusit financiar, kulturës, gjuhës, moshës dhe invaliditetit mendor ose fizike.

- Konkretisht, adresa e vendbanimit iu hiqet vetëm pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare, me çka shqiptarët në Serbi diskriminohen dyfish, si në raport me pakicat e tjera kombëtare ashtu edhe në raport me popullin shumicë - serbët.

- Është shkelur edhe e drejta për gjykim të drejtë, e paraparë me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, sipas të cilit çdokush ka të drejtë të ketë një gjykatë të pavarur, të paanshme tashmë të themeluar me ligj, në mënyrë të drejtë dhe në afat të arsyeshëm, që publikisht të diskutojnë dhe vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij, bazueshmërinë e dyshimit që ka qenë shkak për fillimin e procedurës, si dhe për akuzat ndaj tij.

- Secilit i garantohet e drejta për një përkthyes falas, nëse nuk flet ose nuk kupton gjuhën që përdoret zyrtarisht në gjykatë, dhe e drejta për një përkthyes falas, nëse është i verbër, shurdh ose memec.

- Është shkelur e drejta për mbrojtje të barabartë të të drejtave dhe e drejta në mjetin juridik, nga neni 36 i Kushtetutës: garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave para gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore, bartësve të pushtetit publik dhe organeve të krahinave autonome dhe njësisive të vetëqeverisjes lokale. Kundër vendimit që përcakton të drejtën, detyrimin ose interesin e tij në bazë të ligjit, kushdo ka të drejtën e ankimit ose mjetit tjetër juridik.

- Janë shkelur edhe të drejtat e qytetarëve për lirinë e lëvizjes nga neni 39 i Kushtetutës: Secili ka të drejtë të lëvizë dhe të jetojë lirisht në Republikën e Serbisë, të largohet nga ajo dhe të kthehet në të. Konkretisht, kjo e drejtë përfshin edhe të drejtën e banimit, përkatësisht të vendbanimit, e cila i është hequr parashtruesit në mënyrë të paligjshme.

- Është shkelur edhe e drejta zgjedhore nga neni 52 i Kushtetutës: Çdo

shtetas i Republikës së Serbisë i moshës madhore, me zotësi të veprimit, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjedhet. E drejta zgjedhore është universale dhe e barabartë, zgjedhjet janë të lira dhe të drejtpërdrejta dhe votimi është i fshehtë dhe personal.

E DREJTA E VENDBANIMIT

E drejta e vendbanimit në Republikën e Serbisë u jepet të gjithë shtetasve të Serbisë që jetojnë përgjithmonë në territorin e saj. Kjo e drejtë garantohet me Ligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin e qytetarëve.³⁶ Megjithatë, një numër i madh i qytetarëve përballen me probleme të theksuara që vështirësojnë regjistrimin e vendbanimit. Shkaku i këtyre problemeve nuk janë rregullat joadekuate, por më së shpeshti janë rezultat i veprimeve jo të duhura të autoriteteve që kryejnë procedurat për regjistrimin e vendbanimit. Prandaj, këto probleme duhet të jenë më të lehta për t'u zgjidhur, sepse për ushtrimin e papenguar të së drejtës së regjistrimit të vendbanimit do të mjaftonte që të sigurohen veprime ligjore nga autoritetet, duke shmangur kështu procedurat e stërzgjatura për ndryshimin e rregullave ekzistuese apo miratimin e rregullave të reja. Megjithatë, në vend që problemet të zgjidhen shpejt dhe me efikasitet, shumica e këtyre problemeve përsëriten çdo vit me të njëjtin intensitet.³⁷

Sipas raportit të organizatës Praxis, për shkak të adresave të pasivizuara, shumë qytetarë mbeten plotësisht pa vendbanim të regjistruar ose kanë vendbanim të regjistruar në vende ku nuk kanë jetuar ndonjëherë prej disa dekadash. Personat që nuk kanë fare vendbanim të regjistruar, nuk mund të pajisen me kartë identiteti dhe për rrjedhojë nuk mund të kenë akses në të gjitha ato të drejta për të cilat është e nevojshme posedimi i dokumenteve të identifikimit. Nga ana tjetër, qytetarët, vendbanimet e të cilëve janë regjistruar aty ku nuk jetojnë realisht, nuk ushtrojnë

36 Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve, ("Sl. glasnik RS", br. 87/2011): https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_prebivalistu_i_boravistu_gradjana.html.

37 Praxis, Izveštaj „Prijava prebivališta za marginalizovane građane: Pravo i praksa, 2023, Beograd, f. 1: <https://www.praxis.org.rs/index.php/sr/praxis-in-action/status-and-socioeconomic-rights/item/1762-permanent-residence-registration-for-marginalised-citizens-%E2%80%93-law-and-practice>.

shumë të drejta të tjera në vendbanimet aktuale.³⁸

Probleme rreth regjistrimit të vendbanimit në Serbi kanë banorët e lagjeve joformale dhe pronarët e shtëpive ilegale, pjesëtarët e pakicës kombëtare rome, personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova, të pastrehët dhe të kthyerit sipas marrëveshjes së riatdhesimit. Shumë shpesh, bëhet fjalë për persona që mund të klasifikohen në më shumë se një nga kategoritë e përmendura në të njëjtën kohë. Këta persona janë ndër qytetarët më vulnerabël dhe më të marginalizuar, dhe pozita e tyre rëndohet edhe më shumë nga vështirësitë në regjistrimin e vendbanimit.³⁹

Me nenin 18 të Ligjit⁴⁰ parashihet se me kërkesë të gjykatës, organit shtetëror, organit apo organizatës tjetër dhe personit juridik apo fizik që ka interes juridik të justifikuar, MPB-ja bënë verifikimin nëse shtetasi banon në adresën ku ka të regjistruar vendbanimin. ose vendqëndrimin. Nëse konstatohet se shtetasi nuk është aty, merret aktvendim për pasivizimin e adresës së vendbanimit, përkatësisht të vendqëndrimit. Personi të cilit i është pasivizuar adresa është i obliguar që brenda 8 ditëve të lajmërojë vendbanimin aktual ose pas afatit të përmendur, Ministria e Punëve të Brendshme sipas detyrës zyrtare cakton vendbanimin në pajtim me nenin 11 paragrafi 2 të ligjit, në njërin nga adresat e mëposhtme: vendbanimit të përhershëm, bashkëshortes/tit, prindërve ose qendrës për punë sociale. Prandaj, ligji parashikon që shtetasi i Republikës së Serbisë në asnjë rrethanë nuk duhet të mbetet pa vendbanim të regjistruar, edhe nëse ai i është caktuar me detyrë zyrtare.⁴¹

Pa vendbanim të regjistruar zakonisht nuk është e mundur paisja me kartë identiteti, e cila është dokumenti bazë i identifikimit dhe parakusht për ushtrimin

38 Po aty, f. 2.

39 Po aty, f. 2.

40 Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve, ("Sl. glasnik RS", br. 87/2011): https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_prebivalistu_i_boravistu_gradjana.html;

41 Praxis, Izveštaj „Prijava prebivališta za marginalizovane građane: Pravo i praksa, 2023, Beograd, f. 5: <https://www.praxis.org.rs/index.php/sr/praxis-in-action/status-and-socioeconomic-rights/item/1762-permanent-residence-registration-for-marginalised-citizens-%E2%80%93-law-and-practice>

e një sërë të drejtash.⁴² Kështu, personat që nuk kanë kartë identiteti nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbrojtje shëndetësore dhe sociale, të punësohen, të martohen, të ushtrojnë të drejtën e votës, të fitojnë pasuri dhe të lëvizin lirshëm.⁴³

ANALIZA E MATERIALEVE NGA TERENI

Qytetarët

Shumica e bashkëbiseduesve tanë asnjëherë nuk kanë marrë aktvendim zyrtar për pasivimin e adresës dhe për këtë janë njoftuar më vonë dhe gojarisht.

Ka shembuj të ndryshëm, ndërsa qytetarët e kanë marrë vesh se adresa e tyre është pasivuar kur kanë shkuar për të marrë letërnjoftime të reja, për të zgjatur vlefshmërinë e pasaportave, për të regjistruar vetura, kur kanë dalë për të votuar e të ngjashme. Vetëm me atë rast do të merrnin njoftime verbale nga zyrtarët e policisë se “nuk ishin në sistem”. Gjatë rinovimit të dokumenteve, pos për veten, disa prindër kanë marrë vesh se adresa është pasivuar edhe për fëmijët e tyre. Ajo që është gjithashtu tipike është se pasivizimin e një adrese e mësojnë shumë më vonë se kur ka ndodhur, me këtë që diapazoni kohër variron nga disa muaj në disa vite.

Edhe pse Ligji kërkon marrjen e aktvendimit për pasivimin e adresave, ku para. 4 i nenit 18 gjithashtu lejon ankim brenda 8 ditëve nga marrja e aktvendimit, në shumicën e rasteve të anketuarit tanë nuk kanë marrë asnjëherë aktvendim me shkrim për pasivimin e adresës. Siç u tha, ata mësojnë për pasivizimin e adresës së tyre rastësisht dhe verbalisht nga zyrtarët e policisë. Një numër dukshëm më i vogël i të anketuarve kanë deklaruar se u janë dorëzuar aktvendimet për pasivizimin ose se kanë marrë ftesa nga policia për të dhënë deklaratë për vendbanimin e tyre. Një

42 Ligji mbi letërnjoftimin, (“Sl. glasnik RS”, br. 62/2006, 36/2011 i 53/2021): https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_licnoj_karti.html.

43 Kushtetuta e Republikës së Serbisë (“Sl. glasnik RS”, br. 98/2006 i 115/2021): https://www.paragraf.rs/propisi/ustav_republike_srbije.html.

problem tjetër që lind me dorëzimin e këtij dokumenti është reflektuar në faktin se zgjidhjet janë të shkruara ekskluzivisht në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik. Në shumicën e rasteve, bashkëbiseduesit tanë ose nuk e dinë fare ose njohuritë e tyre për gjuhën serbe janë në nivel modest, prandaj nuk mund ta interpretojnë aktvendimin. Përveç kësaj, aktvendimet e përmendura janë kryesisht tipike dhe pa shpjegime të qarta, për arsye të pasivizimit të adresës së vendbanimit.

Pas pasivizimit, disa të anketuar kanë shkuar në polici për t'u informuar për të drejtat e tyre. Informacionet që morën ishin të ndryshme - disa mbetën pa informacion, ndërsa të tjerëve iu tha të lajmëronin vendbanim në një komunë tjetër ose të prisnin në shtëpi që policia të vinte për verifikim në teren. Disa të anketuar janë këshilluar nga policia që të regjistrojnë vendbanimin e tyre në një adresë të një komune tjetër ose të regjistrojnë adresën e tyre në Graçanicë, në autoritetet paralele të Serbisë. Nga ana tjetër, ata që u këshilluan të prisnin vizita të përsëritura në terren nga policia, u përballën me problemin e zgjatjes së procedurave – vizitat në terren zgjatën disa muaj. Në këtë mënyrë, të anketuarve u duhej të mungonin nga puna, nëse ishin të punësuar, ndërsa të moshuarit i kuptonin këto rekomandime si zgjidhjen e vetme dhe për këtë arsye nuk u larguan nga vendbanimi i tyre deri në disa muaj.

Përveç se iu drejtuan zyrtarëve të policisë për këshilla, **një numër i madh i të anketuarve nuk pyetën më tej për të drejtat e tyre ose** për procesin e kthimit të adresës së tyre **u njoftuan në mjedisin e tyre të afërt dhe nga politikanët lokal.** Një numër më i vogël i tyre vendosën të nisnin procedurat gjyqësore, duke angazhuar avokat. Megjithatë, të gjithë të anketuarit u përballën me faktin se procedura para gjykatës është e ngadaltë dhe pothuajse e paarritshme.

Numri më i madh i të anketuarve nuk e dinin se mund të ankohen ndaj procesit të pasivizimit të adresës. Ankimi brenda 8 ditëve, nga marrja e aktvendimit, është i garantuar me ligj, por bashkëbiseduesit tanë nuk kanë dijeni për këtë procedurë, kryesisht për shkak të mungesës së aktvendimit për pasivizimin. Përveç këtyre, **një numër i konsiderueshëm i të anketuarve nuk kanë dashur të inicojnë procesin e ankesës,** duke besuar se nuk do të arrijnë asgjë me këtë procedurë.

Numri më i vogël i rasteve të regjistruara ka pasur rezultate pozitive pas ankesës ose fillimit të procedurës për caktimin e vendbanimit, përkatësisht të

vendqëndrimet. Vetëm disa të anketuar arritën të lajmërojnë adresën e tyre, por kryesisht pas procedurave të gjata. Në këto raste, policia ka dalë për kontrolle në terren nga 2 deri në 5 herë, ndërsa procesi i përgjithshëm i kthimit të adresës ka zgjatur disa muaj.

Gjatë hulumtimit **kemi evidentuar raste dhe arsye të ndryshme për të cilat janë pasivizuar adresat e të anketuarve.** Grupi i parë përbëhet nga ata që nuk kanë respektuar procedurën e aplikimit për qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, nëse kanë qëndruar atje për më shumë se 90 ditë. Përveç kësaj, ekziston një grup i madh i të anketuarve, adresa e të cilëve është pasivizuar pa një shpjegim të qartë dhe të cilët nuk janë larguar nga vendbanimet e tyre të regjistruara. Shumica e të anketuarve pajtohen se bëhet fjalë për manipulim politik. Sipas mendimit të tyre, pasivizimi i adresave të qytetarëve ka qenë më i shpeshtë në prag të zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, ata theksojnë se parimet strikte të pasivizimit të adresave vlejné vetëm për shqiptarët, duke besuar se qëllimi përfundimtar është ndryshimi i pasqyrës demografike dhe strukturës etnike të popullsisë së kësaj pjese të Serbisë.

Sipas nenit 18 të Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, policia ka të drejtë të verifikoj dhe vërtetojë faktin nëse qytetarët jetojnë apo qëndrojnë përkohësisht në adresën e vendbanimit apo vendqëndrimin të tyre. Sipas përvojës së bashkëbiseduesve tanë, **policia verifikon faktin e vendqëndrimin, përkatësisht të vendbanimit të lajmëruar, por këto kontrolle shumë shpesh përsëriten disa herë dhe zgjasin disa muaj.** Mesatarisht, siç theksojnë të intervistuarit, policia ka ardhur në adresat e tyre nga dy deri në pesë herë brenda pak muajsh. Disa ishin dëshmitarë të drejtpërdrejt të kontrolleve policore, ndërsa të tjerët për këtë mësuhan nga fqinjët e tyre. Përveç kësaj, ka edhe një grup të anketuarish që pretendojnë se policia nuk ka ardhur në adresat e tyre. Bëhet fjalë kryesisht për: a) individë që kanë marrë ftesa për t'u paraqitur në Stacionin më të afërt; b) individët për vendbanimin e të cilëve policia ka pyetur persona të tretë – fqinjë ose të afërm. Numri i të anketuarve që **nuk janë të sigurt nëse policia ka kryer kontrolle në adresën e tyre,** është më i vogli. Këta janë kryesisht ata, adresa e të cilëve është pasivizuar pa arsye të qarta dhe që nuk ndërmarrin hapa të mëtejshëm.

Përveç paqartësisë dhe pasigurisë së përgjithshme, **pasivizimi i adresës sjell edhe probleme thelbësore për qytetarët, duke i penguar ata të funksionojnë**

normalisht në jetën e përditshme dhe duke iu hapur probleme më serioze. Shumica e të anketuarve nuk kanë të drejtë vote për shkak të adresave të pasivuara dhe nuk mund të marrin apo rinovojnë dokumentet personale. Kjo çon më tej në probleme me marrjen e pensioneve apo marrjen e përfitimeve shtetërore dhe sociale, për të cilat është e nevojshme pajisja me kartë identiteti. Ky është një problem i veçantë, pasi prek drejtpërdrejt grupet më të cenueshme të qytetarëve. Përveç këtyre, ka edhe një sërë problemesh të tjera, si pamundësia e fillimit të procedurës së trashëgimisë, regjistrimi i veturës, shitja e pasurisë, lidhja e martesës e të ngjashme.

Një tregues i rëndësishëm se qytetarët jetojnë në adresën e regjistruar si vendbanim, përkatësisht vendqëndrim, paraqesin obligime të rregulluara ndaj shtetit. Kjo ka të bëjë kryesisht me pagesën e faturave, taksave dhe shlyerjen e detyrimeve të tjera qytetare. Meqenëse të gjithë bashkëbiseduesit tanë paguajnë rregullisht taksa dhe detyrime të tjera, dhe shumë shpesh pasuritë apo pronat e paluajtshme regjistrohen në emër të tyre, mbetet e paqartë se si mund të pasivizohen adresat e tyre.

Të gjithë të anketuarit dinin për edhe disa raste të tjera të pasivizimit të adresave nga mjedisi i tyre i afërt ose familja e gjerë. Ata kryesisht flisnin për problemet e pasivizimit me të cilat përballen anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë apo fqinjët e tjerë në vendbanimet e tyre. Narrativat e të anketuarve dominohen nga qëndrimi se pasivizimi i adresave kryesisht ka të bëjë me personat që qëndrojnë, punojnë ose jetojnë jashtë vendit, por edhe për studentët që studiojnë në Kosovë. Qëndrimi i shtetasit jashtë shtetit më shumë se 90 ditë kërkon raportimin në MPB të qëndrimit jashtë vendit para se të largohet ose pas largimit përmes përfaqësisë diplomatike-konsullore (neni 19). Megjithatë, ka edhe mangësi në respektimin e Ligjit nga autoritetet shtetërore, pasi ka një numër të konsiderueshëm të të anketuarve me adresa të pasivuara që nuk kanë shkuar jashtë vendit, ndërsa në të njëjtën kohë, shumë prej tyre kanë vështirësi në regjistrimin e bashkëshortëve në adresën e tyre.

Procedurat e paqarta dhe të paharmonizuara të pasivizimit të adresave, si dhe mosnjohja e kuadrit ligjor, shkaktojnë një ndjenjë të përgjithshme paqartësie dhe pasigurie tek të anketuarit tanë. Ndërsa disa persona ndihen të pasigurt

në funksionimin e tyre të përditshëm, një numër i madh prej tyre kanë frikë të dalin nga shtëpia, nëse janë në proces verifikimi, duke pritur që në çdo moment të paraqitet policia për të kryer verifikimin në teren të adresës së vendbanimit të regjistruar.

Akterët dhe aktivistët politikë

Nuk ka të dhëna të sakta se kur kanë nisur problemet e pasivimit, megjithëse të intervistuarit theksojnë se këto probleme kanë ndodhur në 7-8 vitet e fundit. Një i intervistuar politikisht aktiv thekson se në Medvegje, shembujt e parë të pasivizimit kanë ndodhur në vitin 2015, pikërisht para zgjedhjeve lokale në këtë komunë. Të intervistuar të tjerë theksojnë se për pasivizimin kanë dëgjuar për herë të parë në shembullin e Medvegjës dhe se kjo komunë gjithmonë “shërben si test i parë” kur bëhet fjalë për aktivitetet shtetërore të drejtuara ndaj komunitetit shqiptar.

Akterët dhe aktivistët politikë në jug të Serbisë disa herë u përpoqën të sigurojnë të dhëna të sakta për numrin e banorëve me adresa të pasivuar përmes pyetjeve të bëra me rrugë zyrtare, para së gjithash, në polici, e më pas në institucionet tjera shtetërore. Pavarësisht kësaj, **për askënd nuk janë të disponueshme të dhëna të sakta për qytetarët e pasivuar dhe strukturën demografike të këtyre individëve.** Të gjithë këta akterë kryesisht disponojnë me shifra të përafërta dhe joformale, dhe se në këtë mënyrë vlerësohet se numri i të pasivizuarëve sillet nga 6000 deri në 8000 qytetarë të pasivuar në komunat e Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevës. Organizata të caktuara kanë monitoruar numrin e votuesve dhe kanë vërejtur se ka pasur një ulje drastike të atyre numrave, kështu që, për shembull, në Bashkësinë lokale të Tupallës (komuna e Medvegjës), në vitin 2015 kishte 878 zgjedhës, ndërsa sot janë më pak se 240, ndërsa deri te kjo rënia ka ardhur nga pasivizimi i adresave të qytetarëve. Gjatë hulumtimit kemi ardhur deri te të dhënat për numrin e qytetarëve të pasivizuar, e të cilat në vitin 2021 i kishte pranuar nga policia një organizatë nga Bujanoci. Statistikat e përmendura duken kështu: a) 1782 në Medvegje; 2) 570 në Bujanoc; 3) 92 në Preshevë. Këto statistika korrespondojnë me të dhënat e dërguara parlamentarëve evropianë nga ambasadori serb në Bruksel. Mirëpo, siç theksojnë ata, nga aktivitetet dhe kontaktet e tyre me qytetarët, duket se numri total i të pasivizuarëve është edhe më i lartë.

Ngjashëm me numrin, **as struktura e të pasivizuarve nuk është hartuar zyrtarisht.** Megjithatë, aktorët dhe aktivistët politikë në vlerësimet e tyre joformale janë uniforme në pohimet e tyre se abuzimet më të shpeshta me pasivizimin e adresave përkohë me:

1. individë që punojnë herë pas here jashtë vendit (kta janë kryesisht ata që shkojnë në vendet e Evropës Perëndimore për punë tre mujore);
2. ata që punojnë në Kosovë;;
3. studentët që studiojnë në Kosovë;
4. qytetarë apo aktivistë të angazhuar politikisht nga Lugina e Preshevës.

Grupi më i cënueshëm i qytetarëve të pasivuar nga Lugina e Preshevës janë ata që jetojnë në relacionin Prishtinë/Gnjilane/Fushë Kosovë – Lugina e Preshevës, për shkak të pamundësisë së punësimit, e cila është shkaktuar kryesisht nga problemi ekzistues i mosnjohjes së diplomave. Kjo pjesë e popullsisë paraqet një kategori veçanërisht të cënueshme, pasi që për shkak të ligjeve kufizuese në Kosovë nuk posedojnë dokumente nga Kosova, ndërsa adresat e tyre në Serbi janë të pasivuar. Sipas informacioneve jozyrtare nga aktivistët politikë nga Lugina e Preshevës, numri i këtyre qytetarëve arrin deri në 10.000. Sipas Ardita Sinanit, politikane nga Presheva dhe këshilltare për Luginën e Preshevës, e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, këta persona përballen me probleme serioze për shkak të mungesës së dokumenteve personale - nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre civile, detyrohen të punojnë ilegalisht dhe të ngjashme. Megjithatë, sipas Sinanit, ky problem është njohur në Kosovë dhe po zgjidhet me miratimin e ndryshimeve në Ligjin për lëshimin e dokumenteve dhe Ligjin për shtetësinë. Me miratimin e këtij dokumenti nga Qeveria, do të lehtësohet qëndrimi në Kosovë i shqiptarëve nga Lugina e Preshevës.

Puna e akterëve dhe aktivistëve politikë është e një rëndësie të madhe, sepse janë pikërisht këta si adresa që qytetarët iu drejtohen në ato momente kur sistemi shtetëror nuk funksionon deri në fund. Qytetarët që këtyre iu drejtuan për problemet me pasivizimin e adresave, **akterët politikë dhe aktivistët i drejtuan ata në procedura të mëtejshme – kryesisht për të kontaktuar sërish policinë për aktivizimin e adresës ose avokatët.** Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve mbështeti financiarisht zhvillimin e një aplikacioni ku qytetarët e pasivuar mund

të mësojnë dhe të marrin informacion shtesë për këtë proces. Gjatë hulumtimit, një avokat lokal në Preshevë, i cili në karrierën e tij ka pasur rreth njëzet raste të qytetarëve të pasivuar, thekson se këta persona kanë mundësi të ankohen në polici dhe të kërkojnë rishqyrtim të rastit. Nëse policia merr sërish një aktvendim për pasivizimin, i mbetet vetëm iniciimi i kontestit administrativ. Megjithatë, shumë qytetarë heqin dorë nga këto procedura, sepse kontestet administrative mund të zgjasin për disa vite. Shumë akterë dhe aktivistë politikë pajtohen se procedura e regjistrimit të vendbanimit duhet të lehtësohet ndëra zgjidhja e çështjes së pasivizimit të bëhet sa më e thjeshtë.

Të anketuarit tanë në mënyrë uniforme theksojnë se **pasivizimi shkakton një sërë problemesh të tjera që pengojnë jetën e qetë të komunitetit shqiptar në jug të Serbisë**. Krahas të drejtave elementare civile që u mohohen për shkak të adresave të pasivizuara, qytetarët shpeshherë janë të frikësuar dhe të pasigurt për procedurat e riregjistrimit të adresave. Njëri nga akterët politikë, të cilin e intervistua në Medvegje, tregon shembullin se në disa fshatra të kësaj komune zgjedhjet janë përsëritur pesë herë, sepse në listat zgjedhore kanë dalë votues me adresa të pasivizuara.

Bazuar në përvojën personale dhe kontaktin me individë të pasivuar, akterët dhe aktivistët politikë nga jugu i Serbisë theksojnë se qytetarët e pasivizuar **janë të frikësuar**. Këta qytetarë refuzojnë të flasin publikisht për problemin e tyre, duke besuar se do të kenë më shumë probleme më pas. Ata kanë më shumë frikë se mund të humbasin pasuritë dhe pronat e tyre të paluajtmshme nëse problemet e tyre i adresojnë publikisht. Sidoqoftë, individë dhe aktivistë politikisht aktivë theksojnë se frika e popullatës është se dikush do t'u marrë pronën - frikë nga injoranca, pasi askush nuk ka të drejtë ta bëjë këtë, edhe nëse janë qytetarë të pasivizuar. Në fund, ajo që ata konkludojnë është se pasivizimi është selektiv dhe i drejtuar vetëm ndaj shqiptarëve në jug të Serbisë. Ndër të tjera, në këtë konkluzion kanë ardhur për shkak se minoritetet e tjera apo serbët nga mjedisi i tyre nuk e kanë problem pasivizimin, edhe pse kanë karakteristika të ngjashme demografike.

Ndonëse autoritetet shtetërore theksojnë se pasivizimi i adresave në të gjitha rastet kryhet sipas ligjit, akterët dhe aktivistët politikë theksojnë se **pasivizimi ndodh për arsye të përgjithshme politike, si dhe menaxhim të dobët në shërbime**. Problemi

me administratën e keqe shërbyese reflektohet në faktin se punonjësit e policisë nuk japin udhëzime dhe shpjegime të mira për qytetarët që ndeshen me problemin e pasivizimit. Në anën tjetër, sipas asaj që theksojnë bashkëbiseduesit tanë, problem më të madh paraqet qëllimi politikë, përkatësisht ndryshimi i strukturës demografike të komunave të caktuara, shënjestrimi i komunitetit shqiptar në jug të Serbisë dhe fshirja e shqiptarëve nga këto treva “në kuptim të heshtur”.

CITIMET DHE DEKLARATAT E PËRFAQËSUESVE SHTETËRORË TË SERBISË PËR DHE NË KONTEKST TË PASIVIZIMIT TË ADRESAVE NË LUGINËN E PRESHEVËS

Për vite të tëra ka një trend të mohimit të zbatimit joadekuat të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin ndaj qytetarëve të Luginës së Preshevës, siç dëshmojnë edhe deklaratat e përfaqësuesve më të lartë të Republikës së Serbisë, që nga viti 2011 e deri më sot. “Nuk bëhet fjalë për represion ndaj qytetarëve, por duhet të ketë një pasqyrë të qartë në atë se ku dhe i kujt është vendbanimi dhe vendqëndrimi. Këto janë interesat kombëtare të shtetit në përputhje me rregullat që ekzistojnë në botë”, kishte thënë më 3 nëntor 2011, ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme, Ivica Daçiq. Pikërisht me rastin e arsyetimit në Kuvendin Popullor, të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin, praktikisht shpalli diskriminim ndaj shqiptarëve, duke thënë se “problemi lindi kur shqiptarët nga Kosova filluan të regjistrojnë vendbanimin e tyre në Serbinë qendrore për të marrë pasaportë biometrike”.⁴⁴ Daçiq në këtë mënyrë fajësoi qytetarët e komunitetit shqiptar si të vetmit që regjistrojnë në mënyrë fiktive adresat në Serbi.

Pas zgjedhjeve lokale në Medvegjë në vitin 2015, kur qytetarët panë se procesi i pasivizimit të adresave ishte masiv, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një deklaratë në prill të të njëjtit vit ku thuhej se “ligji zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët pa dallim të përkatësisë kombëtare” dhe se “Drejtorati policor në Vranjë në vitin 2014 ka marrë gjithsej 264 aktvendime për pasivimin e adresave”.⁴⁵ Pas zgjedhjeve lokale në Medvegjë, në vitin 2019, kur Partia Progresive Serbe përsëriti fitoren me partnerët e saj të koalicionit, Nebojsa Stefanoviq, në atë kohë ministër i Punëve të Brendshme, pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve, deklaroi: “U tregua se Medvegja është komunë serbe, se është në Serbi dhe se mbrohen interesat kombëtare serbe”.⁴⁶ Në fushatën zgjedhore ka marrë pjesë edhe presidenti i SNS-së dhe Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili gjatë vizitës së tij në Medvegjë, në fillim të shtatorit 2019 deklaroi se “Medvegja ishte dhe do të mbetet Serbi”.⁴⁷

“Në Serbi nuk ka asnjë fshirje të organizuar të adresave (pasivimit të vendbanimeve) të shqiptarëve dhe nuk ka asgjë përveç zbatimit të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin dhe për këtë kemi arritur mirëkuptim me përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve. (KKSH),” kishte deklaruar për Bujanovaçke, Ministrija për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve dhe dialogut sociale, Gordana Çomiq, më 17 nëntor 2021.

Deputeti i Kuvendit Popullor nga Bujanoci, Nenad Mitrovic, përgjegjës për pasivizimin e adresave në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë ua kalon shqiptarëve, sepse ata nuk kanë dashur të marrin pjesë në regjistrimin e rregullt të vitit 2011. Mitrovic po ashtu tha se ekspertët ndërkombëtarë vlerësojnë se në Bujanoc jetojnë 38.300 banorë, në Preshevë 28.000 dhe në Medvegjë 7.800. “Në të njëjtën kohë

45 Trupi Koordinues për Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë: <http://www.kt.gov.rs/en/news/news-archive/ministry-of-interior-passivation-of-residence-address-applies-to-all-citizens/>.

46 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raporti “Pakica Shqiptare në pritje: Bujanoci, Presheva dhe Medvegja, pengë të marrëdhënieve Serbi-Kosovë, 2021, f. 68.

47 Blic, Vuçiq në Medvegjë: Qëllimi ynë është që njerëzit të qëndrojnë këtu, kjo ishte dhe do të mbetet Serbi, 3.9.2019: <https://www.blic.rs/vesti/politika/vucic-u-medvedi-cilj-nam-je-da-ljudi-ostanu-ovde-ovo-je-bila-i-bice-srbija/mb19362>.

në listën zgjedhore të komunës së Bujanocit kemi 43.000 zgjedhës të regjistruar, ndërsa në Preshevë 41.000”.

Më 23 shtator 2023, kryetari i Trupit Koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, Aleksandar Martinović, hodhi poshtë si të pasakta pretendimet e këshilltares së kryeministrit të Kosovës për ato komuna, Ardita Sinani, se ndaj shqiptarëve në Serbi po ushtrohet “Spastrimi etnik administrativ”. “Nuk ka zbatim të pasivizimit famoz të vendbanimit për shtetasit shqiptarë në jug të Serbisë dhe në këtë kuptim, qytetarët e Serbisë me kombësi shqiptare kanë të drejtë të votojnë me kapacitet të plotë, si të gjithë qytetarët e tjerë të Serbisë”, thoshte Martinović në një komunikatë.⁴⁸

GJETJET E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE ME RASTIN E PASIVIZIMIT TË ADRESAVE

Në maj të vitit 2016, Fondi për të Drejtën Humanitare publikoi informacionin se Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, gjatë atij viti, ka nxjerrë një numër të madh aktvendimesh për qytetarët e përkatësisë shqiptare në jug të Serbisë, veçanërisht nga komuna e Medvegjës, të cilëve iu është pasivizuar vendbanimet e deriatëhershme, që do të thotë se humbasin mundësinë e lëshimit të dokumenteve personale ose zgjatjes së vlefshmërisë së tyre, por edhe të drejtën për shërbime shëndetësore, sociale dhe arsimore, ndërsa mund t'u rrezikohet edhe e drejta e votës. “Numri zyrtar i aktvendimeve të marra në Medvegjë është 539, që në raport me këtë komunë të vogël është përqindje shumë herë më e madhe se në vendet tjera. Prandaj, është indikativ fakti se kjo dispozitë zbatohet në mënyrë shumë më aktive ndaj komunitetit shqiptar”, theksoi FDH-ja, i cili pasi mori përgjigje nga administratat policore (shih tabelën), ato i krahasoi me numrin e banorëve të secilës komunë ose qytet. “Sipas atij krahasimi, aktvendimet e marra vetëm për

komunën e Medvegjës i referohen më shumë se shtatë për qind të popullsisë së kësaj komune, që paraqet një aktivitetet policor me përmasa shumë më të mëdha në këtë komunë, në krahasim me vendet tjera dhe që tregon për një praktikë sistematike. “, u tha nga FDH gazetën Danas.⁴⁹

Në rekomandimet e saj për zgjedhjet e tetorit 2020, Organizata CRTA i bëri thirrje Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale që të ndalojë praktikën e fshirjes nga listat zgjedhore të qytetarëve me adresa të pasivuar. Sipas rekomandimeve të CRTA-s, në ligjet aktuale në Serbi, pasivizimi i adresës së vendbanimit nuk është bazë ligjore për çregjistrimin e vendbanimit, por vetëm dëshmi e organit kompetent se shtetasi nuk jeton në adresën e regjistruar të vendbanimit, në bazë të së cilës lind detyrimi i qytetarit për të regjistruar vendbanimin ose në rast se qytetari nuk e bën, organi kompetent (MPB-ja) është e detyruar të përcaktojë adresën e vendbanimit për atë person. Duke pasur parasysh sa më sipër, nuk ka asnjë bazë ligjore për fshirjen nga lista zgjedhore, të zgjedhësve të cilëve u është pasivuar adresa e vendbanimit. Meqenëse, në periudhën paraprake, Ministria e Punëve të Brendshme i ka dorëzuar raporte MASHVL, në bazë të të cilave janë fshirë nga lista unike zgjedhore, zgjedhësit të cilëve u është pasivuar adresa e vendbanimit, është e nevojshme që kjo praktikë të ndërpritet, pasi nuk ka baza të forta në ligj . Qytetarët, adresat e të cilëve janë pasivizuar, nga pikëpamja e të drejtës së votës, duhet të vazhdojnë të regjistrohen në listën e zgjedhësve me adresën e fundit të vendbanimit të njohur, deri në momentin e ndryshimit të vendbanimit ose caktimit të vendbanimit nga organi kompetent. Në rast se Ministria e Punëve të Brendshme përcakton vendbanimin e qytetarëve, të cilëve u është pasivizuar vendbanimi, një ndryshim i tillë do të sillte ndryshimin e vendbanimit në listën e zgjedhësve, që do të thotë se qytetari mund të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar në një qendër tjetër votimi (të cilit i përket adresa e re e vendbanimit).⁵⁰

49 Danas, MPB abuzon me shqiptarët në jug të Serbisë, 25.5.2016: <https://www.danas.rs/ vesti/ drustvo/ mup-obespravljuje-albance-sa-juga-srbije/>.

50 CRTA, TË NDËRPRITET SHLYERJA NGA LISTA ZGJEDHORE, E ZGJEDHËSVE ME ADRESË TASHMË TË PASIVIZUAR, , , 3.10.2020: <https://crt.rs/76-obustaviti-brisanje-biraca-iz-birackog-spiska-kojima-je-pasivizirana-adresa-prebivalista/>.

Në vitin 2021, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në raportin “Pakica shqiptare në pritje”, shpërfaqti në detaje abuzimin me pasivizimin e adresave, duke e quajtur këtë metodë “spastrim etnik administrativ”. Kjo organizatë u bëri thirrje autoriteteve në Serbi që të ndalojnë menjëherë këtë proces dhe t’i kthejnë të drejtat civile shqiptarëve. Është indikative se kjo masë zbatohet ekskluzivisht për shqiptarët, e jo për serbët që punojnë përkohësisht jashtë vendit.⁵¹

Në raportin, gjegjësisht në amendamentin 79 - të rezolutës për Serbinë të vitit 2021, Parlamenti Evropian ngriti alarmin për keqpërdorimin e Ligjit për vendbanim dhe vendqëndrimin, duke dënuar ashpër diskriminimin në Luginën e Preshevës, si pasojë e pasivimit. Parlamenti Evropian i bëri thirrje Serbisë që të kryejë një hetim të menjëhershëm dhe të plotë të këtyre pretendimeve.⁵²

Më pas, në raportet e tij për progresin në integrimin evropian të Serbisë për vitet 2021 dhe 2022, Komisioni Evropian deklaroi se “pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare shprehën shqetësimin për mënyrën se si policia kontrollon statusin rezidencial në jug të Serbisë, gjë që rezultoi në “pasivizimin” e një numri të caktuar të adresave.⁵³ Komisioni Evropian deklaroi se autoritetet duhet t’i shpjegojnë publikut se si kryhen këto verifikime.⁵⁴

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për gjendjen e të drejtave të njeriut në Serbi për vitin 2022 thuhet: “...shqiptarët etnikë ishin të ekspozuar ndaj diskriminimit dhe papunësisë disproporcionale”. Raporti thekson se liderët shqiptarë etnikë në Serbi pretendojnë se qeveria i ka nënshtruar shqiptarët etnikë në mënyrë disproporcionale ndaj «pasivizimit», në mënyrë që të zvogëlojë numrin zyrtar të shqiptarëve etnikë që jetojnë në Serbi. Policia e bën këtë përcaktim në mënyrë rutinore përmes vizitave spontane në shtëpi. Edhe pse shpesh kryhet gjatë

51 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raporti “Pakica Shqiptare në pritje: Bujanoci, Presheva dhe Medvegja, pengë të marrëdhënieve Serbi-Kosovë, 2021, f. 68.

52 European Parliament Resolution on Serbia, July 6, 2021: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0284_EN.html.

53 Raporti i Komisionit Evropian për Serbinë, për vitin 2021, f. 44: https://www.mei.gov.rs/upload/documents/eu_dokumenta/godisnji_izvestaji_ek_o_napretku/izvestaj_ek_oktobar_21.PDF.

54 Raporti i Komisionit Evropian për Serbinë, 2022., f. 50: https://www.mei.gov.rs/upload/documents/eu_dokumenta/godisnji_izvestaji_ek_o_napretku/Serbia_Report_2022_SR.%5B1%5D.pdf.

orarit të punës, mjafton një vizitë në të cilën personi nuk është i pranishëm për të vërtetuar se nuk banon në atë adresë.⁵⁵

Sipas raportit të Asociacionit Evropian të Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve (ENEMO), për zgjedhjet e mbajtura në prill të vitit 2022, shqetësim të veçantë shprehin pretendimet për heqjen nga lista zgjedhore e zgjedhësve të pakicës etnike shqiptare që jeton në Luginën e Preshevës. Në raportin e sipërpërmendur, ata i referohen raportit të Komisionit Evropian të vitit 2021, i cili thekson se rishikimi i statusit rezidenacial të shqiptarëve etnikë çoi në “pasivizimin” e disa adresave dhe u bën thirrje autoriteteve që të shpjegojnë më mirë publikun se si kryhet kontrolli. Vëmendje e veçantë në raportin ENEMO duhet t’i kushtohet faktit se pak ditë para ditës së zgjedhjeve, në muajin prill, u raportua se nga listat e zgjedhësve ishin fshirë rreth 6000 shqiptarë.⁵⁶

PROBLEMET E TJERA TË DISKRIMINIMIT TË SHQIPTARËVE NË SERBI

Gjatë vizitave në terren, në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ekipi hulumtues ka hartuar disa praktika të tjera potencialisht diskriminuese:

1. Ndalimi i shtetasve me kombësi shqiptare në pikat kufitare me Kosovën:

Gjatë hulumtimit janë evidentuar disa raste të ndalimit të pjesëtarëve të pakicës shqiptare nga Lugina e Preshevës në vendkalimin administrativ me Kosovën. Ndalimet në pikat kufitare janë shumë të shpeshta - disa herë brenda disa muajve, zgjasin deri në disa orë dhe kryhen pa shpjegime të qarta se përse ndodhin. Me

55 US Department of State, 2022 Country Reports on Human Rights Practices: Serbia: <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/serbia>.

56 ENEMO, ENEMO International Election Observation Mission Presidential and Early Parliamentary Elections, 03 April - Serbia 2022 STATEMENT OF PRELIMINARY FINDINGS AND CONCLUSIONS 04 April, 2022: <https://enemo.eu/uploads/file-manager/ENEMOStatementofPreliminaryFindingandConclusionsSerbia2022.pdf>

këtë rast do të përmendim dy raste konkrete, për të cilat kemi leje për publikim. Shembulli i parë është i Nexhat Agushit, profesor i gjuhës angleze në shkollën e mesme teknike në Preshevë dhe përkthyes gjyqësor për anglisht, shqip dhe serbisht. Nga qershori deri në shtator të vitit 2023, Agushi është ndalur tri herë në pikën e kalimit administrativ me Kosovën, pa ndonjë arsye apo shpjegim të veçantë. Probleme të ngjashme kishte edhe Ardita Sinani, politikane e Partisë për Veprim Demokratik. Gjatë bisedës, Sinani ka theksuar se në pikën kufitare me Kosovën, në periudhën prej 7 gushtit deri më 5 shtator 2023, është ndalur 20 herë, po ashtu pa ndonjë sqarim apo arsyetim. Një veprim i tillë i pjesëtarëve të MPB-së parandalon lëvizjen e papenguar të këtyre individëve dhe shkakton ankth dhe frikë në çdo udhëtim të radhës.

2. Ndalimi i shfaqjes së filmave në gjuhën shqipe:

Shtëpia filmike Colosseum Production nga Presheva ka hasur në një problem të madh, pasi dy filmat e saj të shkurtër kanë përfunduar në Gjykatën e Lartë në Vranjë. Bëhet fjalë për filmat “I pabesi” dhe “Heshtja vret”, të autorit shqiptar Gani Veseli. Përkatesisht, me vendim të Gjykatës së Lartë në Vranjë, të datës 14 gusht 2023, ndalohet shfaqja e filmit “I pabesi” në Serbi. Trupi gjyqësor ka vlerësuar se propozimi i Prokurorisë Publike është i bazuar dhe se ky akt “avokon dhe nxit urrejtje”. Me të njëjtin vendim lejohet shfaqja e filmit «Heshtja vret» me kusht që, ndër të tjera, të hiqet simboli i Republikës së Kosovës nga titulli i hapjes dhe mbylljes dhe të tregohet se filmi nuk rekomandohet për personat nën moshën 16 vjeç.⁵⁷

3. Mosnjohja e diplomave të arsimit të lartë të fituara në Kosovë:

Gjatë hulumtimit është vënë në dukje edhe problemi i mosnjohjes së diplomave të arsimit të lartë të fituara në Kosovë. Gjegjësisht, një numër i madh i të rinjëve, të cilët vazhdojnë shkollimin në Kosovë, para së gjithash për shkak të pengesës ekzistuese gjuhësore në Serbi, më vonë nuk arrijnë të punësohen në Serbi, sepse nuk ka mundësi për njohjen e diplomave të Kosovës, në Republikën e Serbisë. Për

shkak të kësaj, një numër i madh i tyre janë të punësuar në Kosovë ose, nga ana tjetër, shkojnë për të punuar në vendet e Evropës Perëndimore, kështu që Serbia humb një pjesë të popullatës së saj me arsim të lartë.

4. Mospërfaqësimi i shtetasve me kombësi shqiptare në institucionet shtetërore:

Një problem tjetër me të cilin ballafaqohen shqiptarët në jug të Serbisë është integrimi i pamjaftueshëm në institucionet shtetërore. Gjatë bashkëbisedimit me hulumtuesit e Nismës, Ardita Sinani ka deklaruar se shqiptarët përbëjnë vetëm 15 % të të punësuarëve në institucionet shtetërore në nivel të qarkut të Pçinjës. Për këtë problem tregon edhe Enkel Rexhepi, nga Këshilli Kombëtar shqiptar në Preshevë, i cili thekson se shqiptarët e punësuar në institucionet shtetërore janë kryesisht individë të moshuar në prag të pensionit ndërsa në ata po zëvendësohen me qytetarë joshqiptarë. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e shqiptarëve dhe integrimi i tyre në sektorin shtetëror po zvogëlohet gradualisht. Sipas tij, vendet e punës në institucionet publike në Preshevë i marrin qytetarët e nacionalitetit serb nga qytetet e afërta - kryesisht Nishi dhe Vranja, duke e regjistruar adresën e tyre në një nga fshatrat e Preshevës.

REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË SERBISË

- Sektori i Kontrollit të Brendshëm i MPB-së dhe Prokuroria Publike e Republikës të hetojnë veprimet e stacioneve policore në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, lidhur me zbatimin restriktivë dhe arbitrar të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin;
- **Mbrojtësi i qytetarëve të kontrollojë ligjshmërinë e punës së MPB-së gjatë pasivimit të adresave në komunat Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë;**
- **Komisioneri për mbrojtjen e barazisë t'i shqyrtoj veprimet e MPB-së në pasivizimin e adresave të shtetasve me kombësi shqiptare dhe të japë mendim dhe rekomandime për zbatimin jodiskriminues të Ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin;**
- Është e nevojshme që Ministria e Punëve të Brendshme të publikojë sa më shpejt statistikën e plota të qytetarëve **në Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë, adresat e të cilëve janë pasivizuar nga viti 2011 deri në vitin 2023 me ndarje sipas përkatësisë kombëtare/etnike;**
- Është e **domosdoshme** që Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale të pezullojë procesin e fshirjes së qytetarëve, **me adresa të pasivuara, nga lista unike zgjedhore;**
- Është e **domosdoshme** të dorëzohen **aktvendimet me shkrim mbi pasivimin e adresës**. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët do të kenë mundësi që me kohë të ndikojnë në këtë proces dhe të raportojnë adresën e vërtetë të vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin.
- **Aktvendimet për pasivizimin duhet të shkruhen në dy gjuhë - në serbisht dhe shqip.** Hulumtimi tregoi se një numër i madh i bashkëbiseduesve ose nuk e dinë ose e flasin serbishten në një nivel modest. Në këtë kuptim, edhe sikur t'u jepeshin aktvendimet, për shkak të pengesës gjuhësore, nuk do të përmbushnin funksionin e tyre parësor - informimin e qytetarëve.
- **Aktvendimet duhet të jenë më të sakta, jo gjenerike dhe të përgjithshme.** Në çdo aktvendim duhet të ketë informacion të qartë se kush ka kërkuar riverifikimin e adresës, për çfarë arsye është nisur procedura e përmendur dhe të theksohet mjeti juridik.

- Është me rëndësi standardizimi dhe rregullimi i procedurës për pasivizimin e adresave në nivel të gjithë Republikës së Serbisë. Nëse pasivizimi i adresave zbatohet rreptësisht vetëm në disa komuna të vendit, hap mundësi për dyshime se ky proces është i orientuar drejtpërdrejt vetëm ndaj një komuniteti.
- **Procedura e kontrollit dhe përcaktimit të adresës së regjistruar të vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit, duhet të jetë e kufizuar në kohë.** Sipas informacioneve të deritanishme, kjo procedurë zgjat disa muaj, ndërsa policia del për kontrole në terren deri në 5 herë. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të krijohen kritere të qarta që do të përcaktojnë kohëzgjatjen dhe formën e procedurës për përcaktimin e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin e qytetarëve dhe të drejtat e punonjësve të policisë në këtë procedurë.
- **Zbatimi i pasivizimit në bazë të parimit të përshtatshmërisë,** që del nga Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin. **Asnjë shtetas i Republikës së Serbisë nuk duhet të jetë pa vendbanim. Është e këshillueshme që MPB-ja fillimisht të përpiqet të përcaktojë adresën e secilit qytetar dhe jo** që hapi i parë të jetë **pasivizimi i adresës.** Edhe pse vetë Ligji u garanton qytetarëve se do të kenë adresën e vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit, edhe nëse kjo është caktuar me detyrë zyrtare, në jetën e përditshme nuk është kështu. Mungesa e adresës i privon qytetarët nga të drejtat themelore të njeriut, prandaj është e nevojshme respektimi i kornizave ligjore.
- **Të bëhen të disponueshëm publikisht treguesit statistikorë për numrin dhe demografinë e qytetarëve të pasivizuar.** Këto të dhëna duhet të jenë të disponueshme publikisht, e jo të fshehura. Nëse pasivizimi është një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Republika e Serbisë, për zgjidhjen e tij duhet të shfrytëzohen të gjitha kapacitetet në dispozicion – që nga politikanët lokal, aktivistët, organizatat joqeveritare etj..
- **Të hartohen pamflete dygjuhëshe që do të jenë të disponueshme në shërbimet policore.** Në këtë mënyrë, të gjithë qytetarët që përballen me problemin e pasivizimit të adresave, do të kishin mundësi të informoheshin në mënyrë të thjeshtë për hapat e mëtejshëm për zgjidhjen e këtij problemi.
- **Zyrtarët e punësuar në sportelet e drejtorisë policore duhet të dinë, të paktën në nivelin bazik, gjuhën e pakicës kombëtare.** E vetmja mënyrë që qytetarët të kalojnë në mënyrë të sigurtë të gjitha procedurat e garantuara me ligj, është të mos hasin në barrierë gjuhësore. Në këtë kuptim, zyrtarët që punojnë me palët duhet të dinë edhe gjuhët e pakicave kombëtare në komunat e tyre.

